

**PLANI I VEPRIMIT PËR PËRDORIMIN E
QËNDRUESHËM TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN
E BIMËVE NË SHQIPËRI
PËR VITET 2022-2032**

(Draft)

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Objektivat e përgjithshme dhe bazat ligjore të Planit të Veprimit .Error! Bookmark not defined.	
2.1 Objektivat e Planit të Veprimit	Error! Bookmark not defined.
2.2 Aktet ligjore të BE-së për PMB-të	Error! Bookmark not defined.
2.3 Aktet ligjore shqiptare për PMB-të	Error! Bookmark not defined.
3. Prodhimi bimor në Shqipëri	12
4. Masat në fuqi në lidhje me uljen e rreziqeve që vijnë nga tregtia dhe përdorimi i PMB-ve në Shqipëri	Error! Bookmark not defined.
4.1. Regjistrimi produkteve për mbrojtjen e bimëve për tregtim dhe përdorim	19
4.2. Shitjet e produkteve për mbrojtjen e bimëve	Error! Bookmark not defined.
4.3. Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve	Error! Bookmark not defined.
4.4 <i>Tregtimi i PMB-ve</i>	Error! Bookmark not defined.
4.5. Mbledhja e të dhënave	Error! Bookmark not defined.
4.6. Gjurmimi në tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve	Error! Bookmark not defined.
4.7. Monitorimi i mbetjeve të pesticideve	Error! Bookmark not defined.
5. Objektivat, qëllimet masat dhe afatet për të zvogëluar rreziqet dhe ndikimet e përdorimit të PMB-ve në shëndetin e njeriut dhe mjedisin	Error! Bookmark not defined.
5.1 Objektivat e përgjithshme	Error! Bookmark not defined.
5.2 Trajnimi, shitja e PMB-ve, informimi dhe ndërgjegjësimi..	Error! Bookmark not defined.
5.2.1 Trajnimi.....	Error! Bookmark not defined.
5.2.2 Shitja e PMB-ve.....	Error! Bookmark not defined.
5.2.4 Informimi dhe ndërgjegjësimi	Error! Bookmark not defined.
5.3 Mbledhja e të dhënave	Error! Bookmark not defined.
5.4. Pajisjet për aplikimin e PMB-ve	Error! Bookmark not defined.
5.4.1 Inspektimi dhe certifikimi i pajisjeve në përdorim.....	Error! Bookmark not defined.
5.4.2. Praktikat dhe përdorimet specifike të PMB-ve	Error! Bookmark not defined.
a) Aplikimi ajror.....	Error! Bookmark not defined.
5.5 Mbrojtja e organizmave të pasyruara, mjedisit ujor dhe ujit të pijshëm..	Error! Bookmark not defined.
5.5.1. Mbrojtja e organizmave të pasyruara	Error! Bookmark not defined.
5.5.2. Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	Error! Bookmark not defined.
5.5.3 Mbrojtja e ujit të pijshëm	44
5.5.4 <i>Distancat e sigurisë nga ujërat sipërfaqësore</i>	45
5.5.5 Reduktimi i përdorimit të PMB-ve në zona të veçanta.	Error! Bookmark not defined.
5.6 Trajtimi dhe ruajtja e PMB-ve dhe trajtimi i paketimit dhe mbetjeve të tyre nga përdorues profesionistë.....	Error! Bookmark not defined.
5.7 <i>Menaxhimi i integruar i Dëmtuesve (MID)</i>	Error! Bookmark not defined.

Akronime dhe shkurtesa

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
BE	Bashkimi Evropian
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
DPSMM	Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Mjedisit
DRVMB	Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
EFSA	Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
FDHS	Fleta e të Dhënave të Sigurisë
FRAC	Komiteti i Veprimit për Rezistencën ndaj Fungicideve
HRAC	Komiteti i Veprimit për Rezistencën ndaj Herbicideve
INSTAT	Instituti i Statistikave
IRAC	Komiteti i Veprimit për Rezistencën ndaj Insekticideve
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISUV	Instituti për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë
KE	Komisioni Evropian
LV	Lënda vepruese
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MID	Menaxhimi i Integruar i Dëmtuesve
MP	Mbetjet e Pesticideve
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NMM	Niveli Maksimal i Mbetjes
PAPMB	Pajisje për Aplikimin e PMB-ve
PIK	Pika e Inspektimit Kufitar
PMB	Produkt për Mbrojtjen e Bimëve
RASFF	Sistemi i Alarmit të Shpejtë për Ushqim për njerëz dhe për kafshë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1. HYRJE

Objektivi kryesor i bujqësisë shqiptare është prodhimi i produkteve ushqimore të sigurta dhe cilësore, në sasi që garantojnë një nivel të kënaqshëm të prodhimit të pavarur në Republikën e Shqipërisë. Përdorimi i qëndrueshëm dhe efikas i burimeve të disponueshme të prodhimit, është baza për garantimin e sigurisë ushqimore, që nënkupton një nivel adekuat të plotësimit të kërkesës për produkte ushqimore në terma afatgjatë dhe që mund të ketë një ndikim pozitiv për stabilitetin dhe cilësinë e furnizimit me produkte ushqimore në Shqipëri, ku kushtet mjedisore janë të favorshme për bujqësinë.

Produktet për mbrojtjen e bimëve (PMB-të), janë një faktor i rëndësishëm për garantimin e prodhimit të produkteve ushqimore dhe nivelit të kënaqshëm të tyre. Ato i mbrojnë bimët dhe produktet bimore, duke eliminuar ose pakësuar konkurrencën e bimëve dëmshme dhe dëmet nga dëmtuesit. Gjithashtu, mbrojnë dhe garantojnë cilësinë e duhur të produkteve bujqësore, dhe ulin kostot e punës. Për këtë arsye, PMB-të luajnë rol thelbësor në garantimin e sigurisë ushqimore dhe furnizimit të sigurt të prodhimit bujqësor përgjatë gjithë vitit. Për më tepër, PMB-të kontribuojnë në rezerva ushqimore frutash dhe perimesh të një cilësie të mirë me çmime të përballueshme, duke i bërë ato të disponueshme për të gjithë konsumatorët.

Përdorimi i PMB-ve ul nevojën për tokë bujqësore për sa i përket prodhimit të produkteve ushqimore dhe mundëson prodhimin e një shumëllojshmërie të gjerë të këtyre produkteve në nivel lokal, gjë që mund të ulë kostot e transportit dhe bën të mundur pasjen e më tepër toke në dispozicion për përdorime të tjera, p.sh. për zona publike, parqe natyrore dhe për mbrojtjen e biodiversitetit.

Megjithatë, pavarësisht nga avantazhet e tyre për sa i përket bujqësisë në veçanti, përdorimi i PMB-ve mund të ketë edhe pasoja negative, pasi ato çlirohen në mjedis gjatë përdorimit, gjë që mund të çojë në rrezik ndaj njerëzve dhe mjedisit.

Në strategjinë e zhvillimit të teknologjive të bujqësisë dhe produkteve ushqimore, objektivat strategjike të politikës bujqësore, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor, përcaktohen si më poshtë:

- a) garantim i sigurisë ushqimore nëpërmjet prodhimit të qëndrueshëm të produkteve ushqimore të sigurta cilësore, dhe me çmime të përballueshme për të gjithë konsumatorët;
- b) rritje të konkurrencës në teknologjitë agroushqimore;
- c) shfrytëzim të qëndrueshëm të potencialit prodhues dhe furnizim me të mira publike të lidhura me bujqësinë;
- d) të pasurit një zhvillim të qëndrueshëm dhe harmonik rural (në bashkëpunim me politika të tjera).
- e) përdorim të sigurt për të garantuar shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, si dhe për mjedisin.

Politika bujqësore synon të përfaqësojë një bujqësi me qëllime të shumta, që përdor të gjitha burimet e disponueshme për të mbështetur zhvillimin e saj si një sektor ekonomikisht i qëndrueshëm, efektiv, konkurrues, shoqërisht i përgjegjshëm dhe ekologjikisht i shëndetshëm. E gjithë kjo, përfshin mbrojtjen e qëndrueshme të bimëve kundër dëmtuesve dhe bimëve të dëmshme, gjë që shmang dëmtimin e papranueshëm ekonomik në prodhimin bimor, dëmtimin e biodiversitetit ose praninë e mykotoksinave dhe substancave të tjera të dëmshme, duke përfshirë nivelet e tepërta të mbetjeve të pesticideve në produktet bujqësore.

Prandaj, në prodhimin e ushqimit, si për njerëzit ashtu edhe për kafshët, organizma të tilla duhet të kontrollohen aty ku është e mundur, me anë të metodave mekanike, biologjike, kimike dhe të tjera. Bimët dhe produktet bimore në tregtinë ndërkombëtare, u nënshtrohen masave të nevojshme fitosanitare për të parandaluar përhapjen e dëmtuesve nga zonat e prodhimit drejt zonave të konsumit, veçanërisht midis vendeve dhe kontinenteve të ndryshme.

Masat e reja të politikës bujqësore, synojnë ndër të tjera, transformimin e bujqësisë nga ajo konvencionale në atë të integruar dhe organike, gjë që thekson zbatimin e parimeve të mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së natyrës dhe diversitetit gjenetik në bujqësi. Brenda këtyre sistemeve të prodhimit, rreziku që sjell përdorimi i PMB-ve do të ulet ndjeshëm.

Aktualisht, nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve të gjetura në produktet ushqimore për njerëzit dhe kafshët, janë ende tepër të larta në disa raste, gjë që kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse dhe sistematike për monitorimin e aplikimeve të PMB-ve, si dhe një transformim gradual nga bujqësia konvencionale drejt Menaxhimit të Integruar të Dëmtuesve (MID), ose bujqësisë organike.

Për shkak të shkallës së ekspozimit të bimëve të kultivuara ndaj dëmtuesve dhe bimëve të dëmshme, përdorimi i PMB-ve në bujqësi nuk mund të shmanget. Kushtet klimatike që përcaktojnë prodhimin bujqësor, si dhe rrethanat për zhvillimin e dëmtuesve dhe bimëve të dëmshme, luajnë një rol të rëndësishëm për kultivimin e bimëve në fushë. Nuk mund të pritet një rritje e prodhimit të produkteve ushqimore pa intensifikuar përdorimin e teknologjive të avancuara. Gjithashtu, as niveli i kënaqshëm ushqimor në Shqipëri nuk mund të rritet pa përdorimin e PMB-ve.

Qëllimi i këtij plan-veprimi, është të vendosë synime dhe udhëzime në lidhje me uljen e rrezikut që vjen nga përdorimi i PMB-ve, duke përdorur njohuri të reja, zhvillimin teknik, futjen e risive, edukimin e përdoruesve dhe prezantimin dhe promovimin e MIP-it, duke rritur kështu efektivitetin e përdorimit të PMB-ve dhe duke ulur ndikimet negative që ato mund të kenë në shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, si dhe në mjedis.

Qëllimi i përgjithshëm është të prodhohet ushqim i mjaftueshëm me përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve, bazuar në menaxhimin e integruar të dëmtuesve.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE BAZAT LIGJORE TË PLANIT TË VEPRIMIT

2.1 Objektivat e Planit të Veprimit

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit, është të garantojë veprime që ndihmojnë në minimizimin e rreziqeve për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, që vijnë si pasojë e përdorimit të PMB-ve, duke përcaktuar disa objektiva, veprime, masa dhe tregues. Gjithashtu, Plani i Veprimit është hartuar në kuadër të përafrimit të ligjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së.

2.2. Aktet ligjore të BE-së për PMB-të

Aktet e mëposhtme ligjore në lidhje me tregtinë dhe përdorimin e PMB-ve., të miratura nga BE janë:

1. **Rregullorja (EC) Nr 1107/2009 e Parlamentit European dhe e Këshillit.** “Për vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve” dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 79/117/EEC dhe Direktivën e Këshillit 91/414/EEC.
2. **Direktiva e Përdorimit të Qëndrueshëm 2009/128/KE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 21 tetor 2009, mbi krijimin e një kuadri për veprimin e Komunitetit për të arritur përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve. Kjo direktivë vendos rregulla minimale për përdorimin e pesticideve në Komunitet, në mënyrë që të ulë rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, dhe promovon përdorimin e menaxhimit të integruar të dëmtesuesve. Gjithashtu, parashikon zhvillimin e planeve kombëtare të veprimit nga Shtetet Anëtare. Përafrimi ligjor i kryer në Shqipëri me vendimin nr. 226, datë 13.4.2022 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 317, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave: “Për miratimin e rregullave, për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve, për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret për kualifikimin e përdoruesve”.
3. **Rregullorja (KE) nr. 1185/2009.** Kjo rregullore i detyron Shtetet Anëtare të mbledhin statistika mbi përdorimin e pesticideve. Ndonëse kjo rregullore nuk ka asnjë ndikim shtesë në shumicën e përdoruesve të pesticideve, përdoruesit janë të detyruar t’i vënë të gjitha të dhënat për përdorimin e PMB-ve në dispozicion të autoriteteve kompetente, kur kjo kërkohet. Informacioni i dhënë nga përdoruesit, për qëllime të mbledhjes së statistikave, trajtohet si konfidencial.
4. **Direktiva 2009/127/KE.** Ky legjislacion ndryshon një Direktivë të mëparshme për Makineritë Bujqësore dhe lehtëson përfshirjen e Pajisjeve për Aplikimin e Pesticideve (PAP). Objektivi i tij kryesor është të harmonizojë standardet e prodhimit për pajisjet e reja për aplikimin e PMB-ve përpara se pajisjet të vendosen në treg nga prodhuesi.
5. **Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 540/2011 e datës 25 maj 2011** për zbatimin e Rregullores (KE) nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, lidhur me miratimin e listës së substancave aktive.

6. **Rregullorja (KE) nr. 396/2005.** Kjo rregullore siguron një sistem të harmonizuar për përcaktimin e Niveleve Maksimale të Mbetjeve (NMM-ve) për të gjitha produktet ushqimore të trajtuara me pesticide. NMM-të pasqyrojnë sasinë më të lartë të pesticideve që pritet të gjendet në një bimë të trajtuar, në përputhje me praktikën e mira bujqësore.
7. **Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/KE.** Kjo direktivë angazhon Shtetet Anëtare të BE-së, të arrijnë një status të mirë cilësor dhe sasior të të gjithë mjediseve ujore dhe të krijojnë një kuadër për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës ujore.

Që nga viti 1991, Bashkimi Evropian rregullon sistematikisht përdorimin e PMB-ve në burim, pra gjatë procedurës së regjistrimit të PMB-ve, duke specifikuar mjetet dhe kriteret e përbashkëta për vlerësimin e përshtatshmërisë së PMB-ve në territorin e BE-së. Në vite, BE-ja ka krijuar një sistem gjithëpërfshirës për vlerësimin e rrezikut për shëndetin e njeriut dhe mjedisit, që shkaktohet nga përdorimi i PMB-ve.

Megjithatë, pavarësisht kuadrit ligjor ekzistues, disa PMB mund të gjenden ende brenda zonës së BE-së në sasi të padëshirueshme në tokë, në ujë dhe në mjedisin më gjerë. Produktet bujqësore në territorin e BE-së, mund të përmbajnë ende mbetje që tejkalojnë kufijtë e përcaktuar.

Rreziku i paraqitur për mjedisin ose shëndetin e njeriut, mund të ndodhë nëpërmjet ekspozimit të drejtpërdrejtë të përdoruesve përfundimtarë dhe ekspozimit indirekt (konsumatorëve, banorëve dhe kalimtarëve), veçanërisht gjatë ose pas aplikimit të PMB-ve në bujqësi dhe aktivitete të tjera. Për këto arsye, në BE u miratua Strategjia Tematike për Përdorimin e Qëndrueshëm të Pesticideve, e cila parashikon një sërë masash për arritjen e qëllimit të përbashkët për uljen e rrezikut për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, që vjen si pasojë e përdorimit të PMB-ve.

Një nga masat e para për të arritur qëllimin e përbashkët, ishte Rregullorja 396/2005 për nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve, në ose mbi produktet ushqimore me origjinë bimore dhe shtazore; kjo Rregullore zëvendësoi katër direktiva dhe parashikoi masa të reja që ndihmuan në kufizimin e rrezikut për konsumatorët në fund të zinxhirit ushqimor.

Më pas, u miratua legjislacioni i mëtejshëm në lidhje me pesticidet, duke mbuluar fushat e mëposhtme:

- Vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve (Rregullorja (KE) nr. 1107/2009);
- Udhëzimet për përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve (Direktiva 2009/128/KE);
- Rregulloren për statistikat për pesticidet (Rregullorja (KE) nr. 1185/2009); dhe
- Certifikimin e pajisjeve për aplikimin e pesticideve (Direktiva 2009/127/KE).

i cili plotësoi legjislacionin e nevojshëm të BE-së për arritjen e objektivave të Strategjisë Tematike për Përdorimin e Qëndrueshëm të Pesticideve.

Akti ligjor i BE-së, i cili është baza e drejtpërdrejtë për zhvillimin e planeve kombëtare të veprimit, është Direktiva 2009/128/KE, e cila përcakton një kuadër për arritjen e përdorimit të qëndrueshëm të pesticideve në vendet anëtare të BE-së. Ai parashikon një sërë veprimesh që duhet të planifikohen nga Shtetet Anëtare me synimin për të reduktuar rreziqet që paraqiten për shëndetin

e njerëzve, kafshëve, ose për mjedisin, që vijnë si pasojë e aplikimit të pesticideve për të kontrolluar dëmtuesit e bimëve.

2.3 Aktet ligjore shqiptare për PMB-të

Në Shqipëri, Ligji nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, është akti kryesor që rregullon veprimtaritë në lidhje me PMB-të, duke mbuluar këto aspekte:

- Regjistrimi, me përcaktimet: “1. Të gjitha PMB-të që tregtohen ose përdoren në territorin e Shqipërisë, i nënshtrohen procedurës së regjistrimit. 2. Në Shqipëri mund të regjistrohen vetëm PMB-të e regjistruara në një nga vendet e Bashkimit Evropian”.
- Tregtimi i PMB-ve, me përcaktimin: “1. Lejohet tregtimi me shumicë dhe pakicë i PMB-ve të regjistruara.”
- Tregtimi i materialit bimor, i dezinfektuar, me përcaktimin: “1. Lejohet tregtimi i materialit bimor, të trajtuar me PMB, që është i regjistruar në Shqipëri ose në një vend të BE-së.”
- Transporti dhe magazinimi i PMB-ve, me përkufizimin: “1. Transporti i PMB-ve kryhet me mjete të sigurta dhe adekuate, sipas legjislacionit në fuqi për mallrat dhe lëndët e rrezikshme. 2. PMB-të ruhen në magazina në rastin e shitjes me shumicë, si dhe në ambientet e shitjes me pakicë. 3. Kushtet në magazina dhe njësitë e shitjes me pakicë, duhet të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të PMB-ve, sipas kërkesave të përcaktuara në etiketën e PMB-ve.”
- Përdorimi i qëndrueshëm i PMB-ve, me përcaktimet:

“1. Përdorimi i qëndrueshëm i PMB-ve, duhet të sigurojë uljen e rreziqeve dhe ndikimin e tyre në shëndetin e përdoruesve, konsumatorëve, kafshëve dhe mjedisit, si dhe kontrollin e integruar të dëmtuesve.

2. PMB-të përdoren nga përdoruesi përfundimtar, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet që përmban dokumenti i regjistrimit të tyre.

3. PMB-të shumë helmuese përdoren vetëm nga përdorues profesionistë, të cilët janë të diplomuar në agronomi ose persona të cilët kanë kryer trajnime përkatëse për përdorimin e PMB-ve me rrezikshmëri të lartë dhe janë të pajisur me një certifikatë trajnimi të veçantë për këtë përdorim.

4. PMB-të helmuese përdoren nga përdorues profesionistë, të diplomuar në sektorin e agronomisë ose nga persona që kanë kryer trajnimin e duhur për përdorimin e PMB-ve helmuese dhe janë të pajisur me certifikatë trajnimi për këtë përdorim.

5. Trajtimet e PMB-ve duhet të kryhen me mjete dhe makineri sipas legjislacionit në fuqi për makineritë, i cili përfshin makineritë për përdorimin e PMB-ve, për të garantuar sigurinë e përdoruesve, të mjedisit dhe të bimëve dhe produkteve bimore ku ato përdoren”.

- Ambalazhimi i PMB-ve, me përcaktimin: “1. Lejohet paketimi i PMB-ve, të regjistruara në Shqipëri”.
- Të dhëna statistikore për PMB-të, me përcaktimin: “1. Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me Ministrinë, jep të dhëna statistikore për PMB-të: a) çdo vit për sasitë e hedhura në treg; b) çdo pesë vjet për sasitë e përdorura”.
- Kërkesat e gjurmimit, me përcaktimin: “2. Kultivuesit e bimëve dhe tregtarët e PMB-ve krijojnë një sistem për ruajtjen e të dhënave, të quajtur databaza dhe procedura sigurie, të cilat mundësojnë identifikimin e tyre në çdo kohë. Këto të dhëna duhet të mundësojnë identifikimin e çdo personi fizik ose juridik, i cili ka furnizuar ose është furnizuar me bimë, produkte bimore të rrezikshme, objekte të tjera ose PMB”.

Referuar dispozitave të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, janë hartuar akte nënligjore, të cilat përafrojnë pjesërisht ligjin shqiptar me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, si më poshtë:

1. VKM Nr.335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave të regjistrimit, procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar.

Për zbatimin e kësaj VKM-je janë ngarkuar struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve në Ministri, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), si dhe komisioni i regjistrimit të PMB-ve.

VKM-ja përcakton rregullat, procedurat dhe metodat kombëtare të vlerësimit në kuadër të procesit të regjistrimit të PMB-ve, të cilat janë të regjistruara në të paktën një nga vendet e BE-së, duke marrë parasysh analizën e rrezikut të produktit, të kryer nga Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA).

PMB-të mund të tregtohen dhe përdoren brenda territorit të Shqipërisë vetëm nëse janë të regjistruara. Nga data 1 janar 2021, regjistrimi i PMB-ve bëhet nëpërmjet sistemit *e-Albania*, ku kërkuesi (aplikanti) plotëson drejtpërdrejt kërkesën, duke ngarkuar dokumentacionin sipas kërkesave ligjore.

Dokumentet e regjistrimit dërgohen në formë elektronike pasi të jetë kryer pagesa e regjistrimit dhe të jetë dorëzuar mandate i pagesës në formë elektronike. E gjithë procesi i regjistrimit nga pranimi i dokumentacionit për procedurë regjistrimi deri në miratim, zgjat 50 ditë.

VKM-ja e bën të detyrueshëm publikimin e listës së PMB-ve të regjistruara në faqen zyrtare të Ministrisë, sa herë që ajo pëson ndryshime, në mënyrë që të jetë e aksesueshme për të gjithë individët, palët apo grupet e interesuara. Lista e PMB-ve të regjistruara në Shqipëri dhe etiketa e tyre të miratuara gjendet në linkun: <https://bujqesia.gov.al/lista-e-pmb-ve-te-regjistruara/>.

2. VKM nr. 532, datë 11.9.2018, “Për miratimin e rregullave të tregtimit, transportit, magazinimit dhe ruajtjes së produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar. Ky vendim nuk përafrohet me legjislacionin e BE-së, pasi çdo shtet ka të drejtë ta rregullojë këtë veprimtari.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) janë përgjegjës për zbatimin e kësaj VKM-je, e cila përcakton kërkesat për licencimin e veprimtarive të PMB-ve me shumicë dhe pakicë, si dhe kushtet dhe kërkesat për kryerjen e këtyre veprimtarive pas licencimit, nga importi në shitjet me pakicë. Ai përcakton institucionet shtetërore dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e miratimit të licencimit, si dhe në kryerjen e inspektimeve (që bëhet nga AKU) dhe testimin e mostrave të PMB-ve në treg (që bëhet nga ISUV).

Vëmendje e veçantë i kushtohet rregullave për tregtimin e PMB-ve “shumë helmuese”, veçanërisht PMB-ve që janë gaze helmuese ose që çlirojnë gaze helmuese (fosfina e çliuar nga formulimet me përmbajtje *Fosfid alumini*), për të parandaluar dhe kufizuar helmimin aksidental ose të qëllimshëm të njerëzve - një fenomen shqetësues prej vitesh me humbje jetësh. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, caktohet si institucioni për monitorimin e tregtisë së tyre nga importi tek përdoruesi i fundit.

Inspektimi i PMB-ve të hedhura në treg, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore për tregtinë, kryhet në bazë të planit kombëtar i kontrolleve zyrtare me bazë risku, të miratuar nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë.

Kontrolli i cilësisë së PMB-ve të hedhura në treg kryhet në bazë të planit vjetor të marrjes së mostrave dhe testimit, të miratuar nga Ministri.

Analizat cilësore të PMB-ve kryhen nga ISUV, i cili njofton me shkrim AKU-n brenda dhjetë ditëve për rezultatin e tyre.

Shitja e PMB-ve shumë helmuese u lejonet vetëm përdoruesve profesionistë që janë të diplomuar në agronomi ose personave, të cilët i janë nënshtruar një trajnimit të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve shumë të rrezikshme dhe janë pajisur me dëshmi aftësie të veçantë për këtë përdorim.

3. VKM nr. 317, datë 15.5.2019, “Për miratimin e rregullores për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe kriterëve të kualifikimit të përdoruesve, të ndryshuar. Ky vendim përafrohet pjesërisht me Direktivën 2009/128/KE.

Për zbatimin e kësaj VKM-je ngarkohen Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Të drejtën e përdorimit të PMB-ve të rrezikshme e kanë të gjithë personat që janë të pajisur me dëshmi aftësie.

Dëshmia e aftësisë është pa afat dhe shoqërohet me vërtetim të gjendjes shëndetësore, që lëshohet çdo 2 vjet. Dëshmitë e aftësisë regjistrohen në një regjistër të veçantë që administrohet nga Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve pranë AKVMB-së.

Dëshmia e aftësisë së veçantë është e vlefshme për një periudhë prej 6 vjet dhe shoqërohet me vërtetim të gjendjes shëndetësore, që lëshohet çdo 2 vjet. Dëshmia e aftësisë së veçantë mund të rinovohet nëse kërkohet nga mbajtësi i saj dhe nëse paraqet vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Përgatitja dhe aftësimi i personave që kërkojnë të pajisen me certifikatë trajnimi dhe me certifikatë formimi special, kryhet në institucione publike ose private, të miratuara zyrtarisht sipas legjislacionit për arsimin dhe aftësimin profesional.

Kjo VKM është amenduar, amendim i cili ka hyrë në fuqi në prill të këtij viti. Ky ndryshim ligjor përmirëson kërkesat në lidhje me përdorimin e PMB-ve në ferma, duke vedosur si detyrim ligor për fermerët që prodhojnë për treg të mbajnë dhe të plotësojnë *regjistrin e përdorimit të PMB-ve në fermë*, për fermerët dhe individët, që kultivojnë për konsum familjar, e mbajnë regjistrin në mënyrë vullnetare. Qëllimi i këtij ndryshimi është që përdoruesit e fundit të PMB-ve të mbajnë regjistrin e përdorimit të PMB-ve në fermën e tyre, ku të pasqyrojnë të dhëna për fermën, zonën kadastrale, numrin kadastral/pasurisë, bimën, numrin e trajtimit, arsyen e përdorimit/dëmtuesin, fazën fenologjike të bimës, emrin tregtar të PMB-së dhe të lëndës vepruese, subjektin ku është blerë PMB-ja, sipërfaqen e trajtuar, dozën e përdorur, datën e trajtimit, karencën, datën e vjeljes, shitjen e produktit dhe sasinë.

Përdorimi i PMB-ve është hallka e fundit dhe më e rëndësishme në të gjithë zinxhirin e aktiviteteve nga prodhimi në ferma.

Përdorimi i duhur i produkteve për mbrojtjen e bimëve sipas etiketës së miratuar zyrtarisht për çdo PMB të regjistruar, është thelbësor.

4. Urdhri i Ministrit nr.72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e substancave aktive në përmbajtjen e PMB-ve”, të ndryshuar. Ky Urdhër është hartuar në përputhje me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 540/2011, si dhe është përditësuar në bazë të legjislacionit të BE-së.
5. Plan i Kombëtar i Kontrollave Zyrtare me Bazë Risku dhe të Marrjes së Mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe Inpoteve Bujqësore, si dhe Planin e Marrjes së Mostrave në PIK, i miratuar nga Ministri. Për zbatimin e këtij plani ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme rregullatorë dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarise.

6. Plani i Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me origjinë bimore për produktet: banane, domate, karrota, kastravec, mollë, patate, rrush tavoline, sallatë jeshile, spec, spinaq, ullinj tavolinë, shalqi, pjepër, mandarinë, lakër, pjeshkë + nektarin, shegë dhe luleshtrydhe, i miratuar me Udhëzim të MBZHR. Për zbatimin e këtij plani ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme rregullatorë dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillimin Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarise, si edhe zbatimi i planit monitorohet nga Drejtoria e Rregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit.
7. Udhëzimi nr. 11, datë 10.5.2021, “Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në fruta, perime, fara të freskëta dhe/ose të përpunuara”.

Gjithashtu, aspekte të përgjithshme lidhur me PMB-të rregullohen edhe me legjislacionin e mëposhtëm:

8. Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
9. Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
10. Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 15.3.2022 “Për miratimin e rregullave specifike për paketimin dhe etiketimin e PMB-ve.”

Dy ligjet tek pika 8 dhe 9 janë akte me karakter të përgjithshëm zbatues për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit rregullon mbetjet e pesticideve, mbetjet e paketimit të PMB-ve dhe implikimet e pesticideve për mjedisin.

Në këtë mënyrë, është krijuar baza e nevojshme ligjore për zvogëlimin e rrezikut për njerëzit dhe mjedisin, që rezulton nga përdorimi i PMB-ve; megjithatë, kjo nuk ofron zgjidhje për të gjitha problemet që lidhen me përdorimin e PMB-ve. Përdorimi i papërshtatshëm ose i tepërt i tyre mund të nënkuptojë gjithmonë pasoja negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3. PRODHIMI BIMOR NË SHQIPËRI

3.1 Klima

Shqipëria ndodhet në zonën klimatike nëntropikale (mesdhetare). Ky territor shtrihet në zonën bregdetare të Detit Mesdhe. Në këtë zonë mbizotëron klima nëntropikale (mesdhetare). Karakterizohet nga verë e thatë dhe shumë e nxehtë dhe me dimër të butë e me shi. Dëbora është një dukuri e rrallë në këtë zonë, me përjashtim të maleve më të larta.

Klima në Shqipëri është mesdhetare në pjesën bregdetare dhe në zonën malore ndihet klima e butë-kontinentale dhe malore.

Shqipëria ka një shumëllojshmëri klimash. Me vijën bregdetare të saj përballë detit Adriatik dhe detit Jon në Detin Mesdhe, malet e saj shtrihen në një gjerësi gjeografike me një sërë modelesh të ndryshme të motit gjatë stinës së dimrit dhe verës, kështu që ka një numër relativisht të madh të rajoneve klimatike, për një zonë kaq të vogël. Ultësirat bregdetare kanë klimë tipike mesdhetare, ndërsa zonat malore kanë klimë kontinentale. Si në ultësira ashtu edhe në brendësi, moti ndryshon ndjeshëm nga veriu në jug.

Ultësirat bregdetare kanë klimë tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të thatë. Temperaturat mesatare variojnë nga 7°C në dimër deri në 24°C në verë. Zona malore karakterizohet nga një klimë mesdhetare-kontinentale, e shkaktuar nga masat ajrore që dominojnë Evropën Lindore dhe Ballkanin. Karakteristikat kryesore të kësaj zone janë erërat e forta me drejtim verior dhe verilindor si dhe temperaturat mesatare pak më të ulëta.

Sasia e reshjeve është mesatarisht e lartë si rezultat i kombinimit të dy rrymave ajrore, mesdhetare dhe kontinentale. Niveli i reshjeve varion nga 600 mm në vit në luginën e Korçës, në 3100 mm në vit në Bogë, në Alpet shqiptare. Edhe këtu vlen të theksohet se rreth 95% e reshjeve mbarëkombëtare bien në stinën e dimrit.

Tabela 1. Temperaturat mesatare dhe reshjet në Shqipëri

	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Temperatura mesatare më e ulët (°C)	2.0	2.0	5.0	8.0	12.0	16.0	17.0	17.0	14.0	10.0	8.0	5.0
Temperatura mesatare më e lartë (°C)	12.0	12.0	15.0	18.0	23.0	28.0	31.0	31.0	27.0	23.0	17.0	14.0
Lagështia (%)	71	69	68	69	70	62	57	57	64	67	75	73
Ditë me shi	13	13	14	13	12	7	5	4	6	9	16	17

Burimi: INSTAT

3.2. Toka dhe peizazhi

Shqipëria, me një sipërfaqe prej 28 748 km², shquhet për relievin e saj mjaft të larmishëm. Rreth dy të tretat e territorit përbëhen nga male dhe kodra, ndërsa një e treta e mbetur është fushore, e cila shtrihet kryesisht në perëndim, përgjatë bregdetit të Adriatikut. Pika më e lartë e vendit ndodhet në zonën e Dibrës dhe është mali i Korabit, 2 751 m mbi nivelin e detit.

Ky reliev i pasur, me thyerje dhe mikroforma të shumta, i pasur me burime ujore, pyje dhe florë e faunë, ofron mundësi për veprimtari bujqësore në blegtori (kryesisht të imta) dhe agroturizëm.

Një nga potencialet më të mëdha natyrore të Shqipërisë është numri i lartë i orëve me diell, tregues për të cilin Shqipëria renditet ndër vendet e para në Evropë.

Natyra shqiptare është e pasur me burime ujore, liqene, rezervuarë, lumenj dhe përrenj. Rrjeti hidrografik i territorit të Shqipërisë përbëhet nga 11 lumenj kryesorë, të cilët së bashku me degët dhe përrenjtë e tyre të mëdhenj me prurje të vazhdueshme ujore, arrijnë në 152.

Struktura e kulturave kryesore

Sipërfaqja totale bujqësore e shfrytëzuar e Shqipërisë është 1 174 081 hektarë, e strukturuar siç paraqitet në tabelën 2.

Tabela 2. Toka bujqësore në Shqipëri sipas përdorimit (2020)

Përdorimi bujqësor	Sipërfaqja (ha)	Shpërndarja n përqindje
Tokë are	611 346	52.07%
Kullota dhe livadhe	478 081	40.72%
Kulturat shumëvjeçare	84 654	7.21%

Burimi: MBZHR

Toka bujqësore është rreth 41% e sipërfaqes së tokës së vendit, e cila është e krahasueshme me shumicën e shteteve anëtare të BE-së. Shumica e fermave janë të përziera dhe karakterizohen nga parcela toke dhe tufa bagëtishe shumë të vogla, Bujqësia përbën 21.2% të PBB-së së vendit. Ndërkohë që sipërfaqet totale të kultivuara (Tabela 3) me tokë arë dhe vreshta, janë relativisht të qëndrueshme, totali i sipërfaqeve me agrume, perime në fushë të hapur dhe mbi të gjitha perime serre, është rritur ndjeshëm në vitin 2019 krahasuar me vitin 2015, duke treguar një rritje graduale të orientimit të bujqësisë për treg.

Tabela 3. Sipërfaqet e kultivuara (2015 – 2019)

Kultura	Sipërfaqja e kultivimit (ha) në vitin					Ndryshimi (2015-2019)	
	2015	2016	2017	2018	2019	Vlera (ndryshimi ne ha)	%
Perimet	37 168	38 803	39 423	39 468	41 440	4 272	11.49
Perimet e serrës	1 244	1 406	1 540	1 650	1 734	490	39.39
Pemishtet	205	205	203	185	190	-15	-7.37
Ullishtet	9 225	9 608	9 786	10 008	10 288	1 063	11.52
Agrumet	1 282	1 354	1 394	1 454	1 521	239	18.64
Vreshtat	10 438	10 533	10 695	10 787	10 842	404	3.87
Total	59 562	61 909	63 041	63 552	66 015	6 453	10.83

Burimi: MBZHR 2020

Bujqësia e fermave të vogla mbetet dominuese dhe përbën një nga kufizimet kryesore për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të fermave. Për më tepër, madhësia e kufizuar i pengon fermat të kenë akses në pagesa direkte, inpute më të lira, kredi, etj. Megjithatë, përdorimi i varieteteve dhe racave lokale, blegtoaria e përzier dhe aksesit i kufizuar në treg, funksionojnë në

rastin e fermerëve të vegjël si një perde kundër paqëndrueshmërisë së çmimeve të tregut dhe ndryshimeve klimatike/rreziqeve natyrore, në një ekonomi tradicionale ku qëndrueshmëria duket të jetë më e rëndësishme se një fitim i pasigurt.

Pragu i qëndrueshmërisë së fermës duhet të shihet si dinamik, i varur nga çmimet e tregut, kostoja e jetesës dhe mundësitë e tjera që nxisin migrimin. Studimet sektoriale të përgatitura në vitin 2021, tregojnë se madhësia minimale për qëndrueshmërinë e fermës është 0,20 ha në rastin e serave, 0,5 ha në rastin e fermave të agrumeve, 0,90 ha për vreshtat, 1 ha për perimet e fushes dhe pemtoret dhe 2 ha për ullishtet Megjithatë, qëndrueshmëria ekonomike mund të arrihet vetëm në pragje më të larta, pasi fitimi nga ferma të tilla të vogla mund të mos mbulojë nevojat financiare të një familjeje, ndërkohë që alternativa e aktiviteteve të tjera/migrimi, mbetet tërheqëse.

3.3 Kulturat prioritare

Zona e ulët bregdetare ka kushte shumë të favorshme për prodhimin e perimeve në mjedise të mbrojtura (serra), duke lejuar rritjen e tyre të paktën dy herë në vit.

Domatja është nga perimet që zë sipërfaqen më të madhe në serra rreth 44%, e ndjekur nga:

- kastravecet - rreth 18%,
- speca - rreth 14%,
- pjeprat - rreth 4%, dhe
- perime të tjera - 20%.

Rrethi i Lushnjës është zona, e cila ka sipërfaqen më të madhe të serrave dhe siguron masën kryesore të perimeve për eksport.

Tabela 4: Sipërfaqja e kultivimit (hektarë) të perimeve të hershme të serrave (2015–2020)

Prefektura	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Berat	394	436	478	483	540	544
Dibër	2	3	2	1	5	2
Durrës	57	49	56	89	84	86
Elbasan	98	114	117	119	133	140
Fier	523	609	668	737	773	826
Gjirokastrë	4	2	2	2	1	3
Korçë	0	0	2	2	0	1
Kukës	1	1	1	1	1	1
Lezhë	7	8	10	10	9	9
Shkodër	75	99	115	113	96	96
Tiranë	57	61	64	67	68	66
Vlorë	26	24	26	26	24	24
Shqipëri	1 244	1 406	1 540	1 650	1 734	1 798

Burimi: INSTAT

Tabela 5: Prodhimi i perimeve të hershme në serra (2013-2020)

Prefektura	Prodhimi në vite (tonë)							
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Berat	31 856	18 386	38 555	41 150	44 360	44 175	43 411	43 397
Dibër	47	0	139	208	145	94	321	155
Durrës	4 292	12 657	4 599	4 408	6 203	5 859	5 386	5 214
Elbasan	4 277	5 522	9 796	12 116	11 638	11 887	13 543	14 165
Fier	37 183	38 552	43 618	48 062	63 386	66 385	70 659	78 424
Gjirokastrë	73	1 055	105	72	122	100	120	88
Korçë	0	0	0	0	216	155	0	120
Kukës	95	1 897	139	139	139	140	120	74
Lezhë	475	1 148	666	740	872	910	797	795
Shkodër	4 065	2 486	6 554	8 548	9 800	10 735	9 135	10 918
Tiranë	1 763	7 362	2 762	2 933	2 819	2 943	3 350	2 672
Vlorë	1 125	3 957	1 346	1 297	1 167	1 325	1 146	1 153
Shqipëri	85 250	93 021	108 279	119 673	140 867	144 707	147 988	157 175

Burimi: INSTAT

Tabela 6: Sipërfaqe e kultivuar me perime në fushë (2013-2020)

Prefektura	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Berat	1 770	1 824	1 898	2 113	2 235	2 243	2 373	2 578
Dibër	963	1 111	961	1 076	1 168	1 227	1 263	1 410
Durrës	2 842	2 721	2 722	2 683	2 704	2 736	2 726	2 741
Elbasan	1 925	1 845	1 764	2 057	1 891	1 965	1 969	2 157
Fier	5 386	5 279	5 080	6 097	5 659	5 889	6 664	7 006
Gjirokastrë	543	517	774	520	511	514	721	701
Korçë	1 302	1 408	1 469	1 410	1 479	1 483	1 557	1 877
Kukës	543	513	490	522	480	513	548	542
Lezhë	1 345	878	1 066	1 196	1 297	1 265	1 321	1 329
Shkodër	2 289	2 238	2 158	2 249	2 299	2 275	2 246	2 148
Tiranë	3 836	3 912	3 993	4 106	4 166	4 091	4 178	4 253
Vlorë	1 492	1 432	1 408	1 529	1 628	1 653	1 894	1 961
Shqipëri	24 235	23 678	23 782	25 559	25 515	25 854	27 458	28 704

Burimi: INSTAT

Tabela 7: Zonë e kultivuar me bimë mjekësore dhe etero-vajore (000 hektarë?)

Emri	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Bimë/erëza mjekësore	5.0	5.0	5.0	5.4	5.6	5.6	6.3

Burimi: INSTAT

Tabela 8: Agrumet - sipërfaqja e kultivuar dhe prodhimi në Shqipëri (2018-2020)

Fruta	Sipërfaqja (ha) në total			Sipërfaqja e prodhimit (ha)			Prodhimi (tonë)		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Agrumet total	1 404	1 435	1 488	1 096	1 289	1 329	45 499	46 882	49 201
Mandarinat	1 074	1 089	1 125	811	992	1 024	30 933	31 235	32 159
Portokallet	257	261	272	227	233	239	10 779	11 556	12 436
Limonat	0	85	91	0	64	65	0	4 075	4 590

Burimi: INSTAT

Tabela 9: Frutat - sipërfaqja e kultivuar dhe prodhimi në Shqipëri (2018-2020)

Fruta	Sipërfaqja (ha) në total			Sipërfaqja e prodhimit (ha)			Prodhimi (tonë)		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Pemë frutore në total	19.958	20.361	20.658	16.669	17.232	17.496	274.343	274.423	273.749
Mollë	4.706	4.761	4.814	4.294	4.407	4.420	108.375	107.713	102.167
Kumbulla	2.905	2.919	2.932	2.537	2.626	2.644	41.241	40.928	41.708
Qershi	2.428	2.461	2.482	2.120	2.203	2.237	19.210	19.681	20.471
Nektarina/Pjeshkë	1.347	1.365	1.401	1.229	1.243	1.267	19.472	19.884	20.392
Gështenja	0	2.478	2.484	0	2.406	2.407	0	5.846	5.616

Burimi: INSTAT

Tabela 10: Ullinj - sipërfaqja e kultivuar dhe prodhimi në Shqipëri (2018-2020)

Bimët	Sipërfaqja (ha) në total			Sipërfaqja e prodhimit (ha)			Prodhimi (tonë)		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Ullinj	52 505	53 200	53 802	46 378	47 136	48 102	117 573	98 313	131 971

Burimi: INSTAT

4. MASAT NË FUQI LIDHUR ME REDUKTIMIN E RREZIQEVE QË RRJEDHIN NGA TREGTIMI DHE PËRDORIMI I PMB-ve NË SHQIPËRI

Në Shqipëri, deri në vitin 1994, PMB-të tregtoheshin dhe përdorshin pa ndonjë bazë ligjore specifike për regjistrimin e tyre.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993, “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, tregtimi i PMB-ve filloi të organizohej mbi baza të reja, duke përfshirë edhe regjistrimin e tyre.

Me ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005, “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, të ndryshuar, u hodh një hap i mëtejshëm cilësor në fushën e PMB-ve, pasi ai lejoi regjistrimin e PMB-ve që ishin regjistruar më parë në një vend të BE-së.

Ligji nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, shfuqizon ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005, “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, të ndryshuar. Ky ligj përmban bazën ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij. Aktet nënligjore në zbatim të ligjit janë përgatitur si përafrim i pjesshëm i legjislacionit të BE-së në fushën e PMB-ve.

Regjistrimi i PMB-ve në Shqipëri filloi në vitin 1994 dhe çdo vit ky proces evoluonte dhe përmirësohej, në mënyrë që të fitohej një përvojë e mirë në këtë fushë.

Në vitin 1994, dy aplikantë aplikuan për herë të parë në Shqipëri dhe u regjistruan 12 PMB.

Aktualisht në Shqipëri janë të regjistruara 320 PMB (sipas listës së publikuar në faqen e internetit të Ministrisë, gusht 2022).

Fermerët duhet të zbatojnë parimet e praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve, duke përdorur PMB-të siç përcaktohet në etiketë, si dhe të respektojnë vendimin nr. 317, datë 15.5.2019, “Për miratimin e rregullores për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit”, të ndryshuar, duke përfshirë parimet e Menaxhimit të Integruar të Dëmtuesve.

Që nga viti 2001, një pjesë e përdoruesve profesionistë të PMB-ve në Shqipëri, janë trajnuar në përputhje me legjislacionin e PMB-ve.

Përmirësimi në mbrojtjen e bimeve në vitin 1999, ka kontribuar në përmirësimin e saktësisë së parashikimit të periudhave kritike për mbrojtjen e kulturave kryesore në prodhim dhe në lehtësimin e aksesit në informacion për prodhuesit e bimëve.

Të gjitha masat e marra synojnë të rrisin ndërgjegjësimin e përdoruesve për përdorimin e duhur të PMB-ve, me vëmendje të veçantë në mbrojtjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, mbrojtjen e bletëve, asgjësimin e sigurt të PMB-ve të vjetruara dhe ambalazhimit të mbetjeve PMB. Stimujt për bujqësinë e integruar dhe organike nga politika bujqësore, kanë kontribuar më tej në testimin e kontrollit biologjik dhe metodave të tjera jo-kimike të mbrojtjes së bimeve, aty ku është e mundur, si dhe në këshillimin për përdorimin e PMB-ve më pak të dëmshme, më pak të qëndrueshme dhe lehtësisht të degradueshme, për mbrojtjen e bimëve dhe për një aplikim më të mirë të këtyre produkteve.

Megjithëse kushtet klimatike të Shqipërisë janë të ngjashme me ato të vendeve të tjera të Evropës mesdhetare, përdorimi i PMB-ve është i ndryshëm. Në Evropë, sasitë më të mëdha të PMB-ve të shitura janë herbicidet (42%) dhe më pas fungicidet (39%).

Në Shqipëri vendin e parë e zënë fungicidet (67%), të cilat pasohen nga insekticidet (24%) dhe herbicidet (7%). Duhet të theksohet gjithashtu se 30% e të gjitha PMB-ve të shitura janë inorganike - PMB squfuri dhe bakri, ose një kombinim i tyre.

Për sa i përket strukturës së përdorimit të PMB-ve, është inkurajuese që mbizotërojnë produkte më pak të dëmshme. Më shumë se gjysma e sasisë së fungicideve të përdorura i përkasin PMB-

ve me bazë bakri dhe squfuri, më shumë se dy të tretat e herbicideve janë PMB me bazë glifosate. Në VKM-në nr. 317, datë 15.5.2019 parashikohet se: “Të drejtën e përdorimit të PMB-ve (përdoruesit përfundimtar) e kanë të gjithë personat mbi 18 vjeç, me përjashtim të grave shtatzëna, deri në përfundim të periudhës së ushqyerjes me gji. Të drejtën e përdorimit të PMB-ve të rrezikshme, e kanë të gjithë personat që plotësojnë kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, dhe që janë të pajisur me certifikatë kompetence. Të drejtën e përdorimit të PMB-ve helmuese ose shumë helmuese e kanë të gjithë personat që plotësojnë kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, dhe që janë të pajisur me certifikatë trajnimi special. Këta persona quhen përdorues profesionistë.”

4.1. Regjistrimi i PMB-ve për tregtim dhe përdorim

Në zbatim të ligjit 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, procedura për regjistrimin e PMB-ve në Shqipëri zhvillohet sipas VKM nr. 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave të regjistrimit, procedurës dhe kriteret e vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

Regjistrimi i PMB-ve në Shqipëri bazohet në parimet e mëposhtme:

1. Të gjitha PMB-të që tregtohen ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.
2. Në Republikën e Shqipërisë regjistrohen vetëm PMB-të, të cilat janë të regjistruara në një nga vendet e Bashkimit Europian.
3. Të gjitha proceduarat, që lidhen me regjistrimin e PMB-ve, lëndëve vepruese, si dhe të shtuesve e të bashkëvepruesve kryhen në ministri, pranë SPMB-së, si autoriteti përgjegjës.
4. Rregullat e regjistrimit, procedura dhe kriteret e vlerësimit të PMB-ve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.
5. Miratimi i lëndëve vepruese, i përbërësve të tjerë në përmbajtje të PMB-ve, i të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve, si dhe përditësimi i tyre, në përputhje me legjislacionin e BE-së, bëhen me urdhër të ministrit sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve.

Procesi i regjistrimit nis me një aplikim nga një kompani përkatëse. Kërkuesi (aplikanti) bën kërkesën për regjistrimin e PMB-së, në portalin e-Albania online https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14343, dhe ngakon dokumentacionin e kërkuar sipas 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurën dhe kriteret e vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB) në Ministri është pritëse e kërkesës (aplikimit), ku ben vlersimin praparak dhe pranimin e kërkesës për procedure regjistrimi.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) vlerëson e të dhënave teknik të PMB-ve, pasi delegohet nga SPMB-ja.

Afatet e vlefshmërisë për regjistrimin e PMB-ve janë si më poshtë:

a) 1 vit më shumë se afatet e lëndës/ve vepruese në përmbajtje të tyre, të miratuara me urdhër të ministrit;

b) 3-vjeçare, deri në marrjen e statusit përfundimtar të lëndës/ve vepruese që nuk janë me status të përcaktuar, të miratuara me urdhër të ministrit.

c) përditësuar sipas urdhrit të ministrit për lëndët vepruese në përmbajtjen e PMB-ve.

Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve në Ministri, ISUV dhe komisioni i regjistrimit të PMB-ve, janë përgjegjës për zbatimin e kësaj VKM-je.

Lista e PMB-ve të regjistruara aktualisht në Shqipëri, gjendet në <https://bujqesia.gov.al/lista-e-pmb-ve-te-regjistruara/>.

4.2. Shitjet e produkteve për mbrojtjen e bimëve

Në Shqipëri lejohet tregtia me shumicë dhe pakicë e PMB-ve të regjistruara. Tregtia me shumicë dhe pakicë e PMB-ve bëhet nga persona fizikë, të diplomuar në degën e agronomisë, ose nga persona juridikë, të cilët duhet të punësojnë një ose më shumë persona, teknikë përgjegjës, të diplomuar në këtë fushë. Tregtimi i PMB-ve përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Tregtia me shumicë dhe pakicë i PMB-ve helmuese dhe PMB-ve shumë helmuese kryhet me licencë, të lëshuar sipas kërkesave të legjislacionit, në zbatim të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ministri, me propozim të AKU-t, mund të pezullojë dhe/ose të heqë licencën, në përputhje me pikën 3 të nenit 20 të Ligjit nr. 105/2016 dt 27.10. 2016 “Për mbrojtjen e bimeve”, të ndryshuar, në rastet kur kriteret për dhënien e licencës nuk plotësohen më ose janë shkelur detyrimet e përcaktuara në të, si dhe në rastet kur ka një rrezik serioz për shëndetin publik dhe është urgjente të merren masa parandaluese.

Në njësitë e tregtimit me shumicë të PMB-ve ndalohe:

- a) mbajtja dhe tregtimi i PMB-ve me ambalazhe të pamiratuara;
- b) asgjësimi i ambalazheve dhe i PMB-ve të skaduara apo të dëmtuara;
- c) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz e për kafshë, si dhe i farërave të padezinfektuara, që mund të përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë si: drithëra, bishtajore për kokërr (bizele, bathë, fasule);
- ç) riambalazhimi i PMB-ve;
- d) shitja e PMB-ve me pakicë të përdoruesi i fundit.

Në njësitë e tregtimit me pakicë ndalohe:

- a) shitja e PMB-ve helmuese të personat, që nuk janë të pajisur me dëshmi aftësie, si dhe e PMB-ve shumë helmuese të personat që nuk janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 23, të këtij ligji;
- b) shitja e PMB-ve helmuese dhe shumë helmuese pa recetë;
- c) mbajtja dhe tregtimi i PMB-ve me ambalazhe të pamiratuara;

- ç) asgjësimi i ambalazheve dhe i PMB-ve të skaduar apo të dëmtuara;
- d) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz dhe për kafshë, si dhe i farërave të padezinfektuara, që mund të përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë, si: drithëra, bishtajore për kokërr (bizele, bathë, fasule);
- dh) riambalazhimi i PMB-ve.

Rregullat për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e PMB-ve përcaktohen me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.532, datë 11.9.2018 “Për miratimin e rregullave të tregtisë, transportit, magazinimit dhe ruajtjes së produkteve për mbrojtjen e bimëve”.

4.3. Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve

Sasia e PMB-ve të përdorura para viteve 1990 në Shqipëri ka qenë shumë e madhe për shkak të bujqësisë intensive.

Të dhënat statistikore mbi përdorimin e PMB-ve janë në dispozicion nga FAO.

Nga viti 1991 deri në vitin 1994, sasia ishte shumë e ulët, në krahasim me vitet para viteve 1990 (rreth 10 herë më e ulët, ku përdorej stoku i ish-sistemit të bujqësisë kolektive).

Sasia e përdorur është 6-7 herë më e vogël se mesatarja e vendeve të BE-së (krahasimi në ton dhe në kg/ha).

Sipërfaqja e tokës bujqësore është 696 mijë hektarë, ndërsa ajo e livadheve dhe kullotave është 478 mijë hektarë (INSTAT 2017). Përdorimi i PMB-ve arrin mesatarisht 0.63 kg/ha.

Tabela 11. Përdorimi i PMB-ve në Shqipëri sipas viteve (në tonë).

PMB-të	1991	1994	1998	2000	2005	2010	2015	2018
Total	121	201	285	308	365	590	538	442
Insekticidet	70	117	160	170	194	378	156	128
Herbicidet	5	7	8	8	8	7	68	66
Fungicidet	44	74	101	106	135	189	236	199
Rodenticidet	2	3	6	8	11	9	68	36
Rregullatorët e rritjes	0	0	0	0	11	0	0	2
Të tjera	0	0	0	6	5	7	10	11

Burimi: FAO

Si rezultat i një rishikimi më të plotë të lëndëve vepruese të PMB-ve në tregun e BE-së, numri i lëndëve vepruese të miratuara ka rënë pothuajse në gjysmë gjatë 10 viteve të fundit (para rishikimit: 1.000 lëndë vepruese, pas rishikimit: më pak se 500 lëndë vepruese). Kriteri kryesor ishte rreziku për shëndetin e njeriut dhe mjedisit.

Tabela 12: Importi i produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) (në kilogramë)

PMB-të	2017	2018	2019	2020
Fungicidet	404 637	325 914	442 068	511 889
Herbicidet	162 484	146 542	359 619	299 407

Insekticidet	319 060	219 329	308 848	245 361
Të tjera	154 159	38 007	116 469	76 803
Total	1 040 340	729 792	1 227 004	1 133 460

Burimi: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)

Importi i PMB-ve rregullohet me Ligjin Nr. 105/2016, datë 27.10.2016. “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, VKM Nr. 532, datë 11.09.2018 “Për miratimin e rregullave për tregtimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve të mbrojtjes së bimëve” dhe VKM Nr.335, datë 06.06.2018 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit, procedurën dhe kriteret e vlerësimit për produktet e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar.

4.4 Tregtimi i PMB-ve

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është përgjegjëse për kontrollet zyrtare në Pikat e Kalimit Kufitar dhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në Operatorët e Biznesit që ushtrojnë aktivitetin “*Import dhe tregtim me shumicë dhe ose pakicë të PMB-ve*”, në zbatim të planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë risku të miratuar nga MBZHR.

Operatorët e Biznesit (OB) që ushtrojnë aktivitetin e tregtimit me shumicë dhe ose pakicë të PMB-ve, iu nënshtrohen licencimit sipas kategorisë II.5, të shtojcës së Ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009, “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar.

Aktualisht, Shqipëria po përballet me sfidat kryesore të mëposhtme në lidhje me sektorin e tregtisë së PMB-ve:

- 1: Tregtimi i PMB-ve nga subjekte të palicencuara (informalitet).
- 2: Tregtimi i PMB-ve të pargjistruara¹ dhe pamundësia për të gjurmuar PMB-të.
- 3: Tregtimi i PMB-ve përtej afateve të skadencës (të vjetëruara).
- 4: Tregtimi i PMB-ve të klasifikuara me toksicitet akut, kategoria 1, 2 dhe 3 sipas legjislacionit shqiptar, për Klasifikimin, Etiketimin, Paketimin, tek personat, që nuk janë të pajisur me certifikatë trajnimi dhe/ose certifikatë trajnimi të veçantë.
- 5: Tregtimi i PMB-ve të klasifikuara si toksicitet akut kategoria 1, 2 dhe 3 sipas legjislacionit shqiptar për Klasifikimin, Etiketimin, Paketimin, tek personat që nuk janë pajisur me recetë nga një agronom.
- 6: Problematikat e hasura në analizimin e PMB-ve dhe kthimin e përgjigjeve për mostrat e analizuar brenda afateve të përcaktuara.
- 7: Mosasgjësimi i PMB-ve të bllokuara në ambientet e njëjësive të tregtisë me shumicë dhe pakicë ndër vite.
- 8: Bllokimi i PMB-ve për vite të tëra duke mos ndjekur procesin e asgjësimit të tyre sipas kërkesave të nenit 25 të ligjit nr.105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, mbetet një

¹ Problematike në këto raste është edhe mungesa e gjurmimit. Rastet e tilla që janë vërejtur u kanë kaluar për ndjekje organeve kompetente.

shqetësim serioz për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Sipas ligjit, asgjësimi në Shqipëri duhet të kryhet nga kompani të autorizuar.

Konkluzione: Kontrolli i PMB-ve të hedhura në treg si dhe kontrolli i cilësisë së PMB-ve që kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve ligjore të tregtimit, kryhen në bazë të planit vjetor të inspektimeve dhe marrjes së mostrave me bazë risku, të miratuar nga Ministri. Plani vjetor i inspektimit është hartuar për 12 Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe është i ndarë në 12 muaj. Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit në fuqi, AKU kryen kontrolle zyrtare të paplanifikuara referuar kërkesave të Operatorve të Biznesit (OB), denoncimeve nga qytetarët, mediat etj., si dhe urdhra të posaçëm të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së apo ministrit.

Në vitet 2017-2020, AKU ka kryer 4 602 inspektime në operatorët e biznesit që ushtrojnë aktivitetin e “Importit, tregtisë me shumicë dhe/ose pakicë të PMB-ve”.

Nga shqyrtimi i kërkesave të paraqitura nga operatorët e biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për marrjen e licencës për aktivitetin e tregtisë me shumicë dhe/ose pakicë të PMB-ve, rezulton se për vitet 2017-2020 janë pranuar 423 kërkesa nga AKU. Prej tyre janë miratuar 280 kërkesa dhe janë refuzuar 141 kërkesa. Dy aplikime ishin të pasakta².

Tabela 13: Inspektimet e realizuara bazuar në kërkesat e OB për t’u pajisur me licence në aktivitetin “Tregtim me shumicë dhe ose pakicë të PMB-ve, për vitet 2017-2020

Viti	Aplikim për licencë QKL	Miratimet	Refuzimet	Aplikime të pasakta
2017	124	71	53	0
2018	115	75	40	0
2019	114	84	30	0
2020	70	50	18	2
Total	423	280	141	2

Burimi: AKU

Gjatë kontrolleve zyrtare të kryera, në operatorët e biznesit ku gjatë inspektimeve janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore janë marrë masa administrative përkatëse konform legjislacionit në fuqi (Paralajmërimë, Gjoha, Ndërprerje aktiviteti, Bllokim produkti për mbrojtjen e bimëve/PMB).

Nga viti në vit vihet re zyrtarizimi i më shumë subjekteve që operojnë në fushën e tregtimit të PMB-ve në rrugë informale pa licencë për këtë veprimtari, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të ruajtjes së PMB-ve në njësitë e tregtimit dhe sistemimi e mirëmbajtja e dokumentacionit shoqërues të mallrave dhe tregtimit të PMB-ve. Këto përmirësime janë rezultat i inspektimeve

² Tërheqja nga sistemi me kërkesë të aplikantit

periodike dhe këshillimeve të vazhdueshme të subjekteve, si dhe i masave administrative të marra. Pavarësisht kësaj, zbatimi i detyrimeve ligjore do të mbetet fokusi kryesor i objektivave të punës për të minimizuar dhe parandaluar problemet.

Tabela 14. Inspektimet e kryera në operatorët e biznesit që ushtrojnë aktivitetin “Tregtia me shumicë dhe/ose pakicë e PMB-ve” (2017-2020)

Nr	Viti	Inspektimet e kryera PMB
1.	2017	1566
2.	2018	1146
3.	2019	1075
4.	2020	815
5.	Total	4602

Burimi: AKU

Në zbatim të planit të marrjes së mostrave dhe analizimit të treguesve të cilësisë (përmbajtjes së lëndës vepruese) të PMB-ve nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në periudhën 2017-2020 janë planifikuar 147 mostra dhe janë marrë 85 mostra dhe janë dërguar për testim në laboratorin e ISUV. Nga mostrat e dërguara për analizimin në vitet 2018-2020, duke iu referuar përgjigjeve të analizimeve të dërguara nga ISUV, 30 mostra janë konform, dhe 5 mostra nuk janë konform.

Nga 35 mostra zyrtare të dërguara nga AKU në korrik 2020 në laboratorin ISUV, deri në nëntor 2021 janë analizuar vetëm 31 mostra dhe rezultatet janë dërguar në AKU. Nga 31 mostra, 5 mostra ishin jo konform dhe rezultatet e analizave të tyre varionin nga 6-7 muaj deri në një vit vonesë. Referuar ndjekjes së gjurmueshmërisë është konstatuar se PMB-të jo konform në fjalë, nuk u gjendën gjëndje në ambientet e subjektit të kontrolluar, por ishin tregtuar tek përdoruesi i fundit. Bazuar në raport, analizat e laboratorit të ISUV kanë rezultuar me lëndë aktive jashtë normave të përcaktuara në certifikatat e cilësisë që shoqërojnë PMB-të, si produktet për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë lëndë vepruese me emrin: “*dimethoate* 40 %” (2 mostra). “*abamectin*”, “*chlorpyrifos*” dhe “*hydroxide* bakri 37.5%”.

Mos kryerja e analizave të PMB nga ISUV, bazuar në shkresat dërguar Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, me Nr. 625 prot., datë 05.07.2017 dhe Nr. 458/1 Prot., datë 19.06.2018, dhe me lëndë “Mbi analizimin e mostrave të PMB-ve, bëri të mundur mos realizimin nga AKU të zërit (analizë të PMB-ve) si dhe kontrollin e cilësisë së PMB-ve të vendosura në treg të parashikuara në planin vjetor të marrjes së mostrave me bazë risku, për vitet 2017, 2018 dhe 2019 (miratuar nga Ministri).

Raportimi me vonesë i rezultateve të testimit të PMB-ve nga laboratorin ISUV, bie ndesh me VKM nr. 532, datë 11.9.2018 “Për miratimin e rregullave të tregtisë, transportit, magazinimit dhe ruajtjes së produkteve për mbrojtjen e bimëve”, Kreu II, Pika 8 citohet: “Analizat cilësore të PMB-ve kryhen nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i cili njofton me shkrim AKU-në, brenda 10 ditëve, për rezultatin e analizave.”

Tabela 15: Mostrat e marra dhe të analizuarra për treguesit cilësor të PMB-ve, vitet 2017-2020

Viti	Numri i mostrave PMB në ISUV				
	Të planifikuar	Aktualë	Në përputhje	Jo në përputhje	Pa përgjigje
2017	44	0	0	0	0
2018	33	15	0	0	15
2019	36	35	0	0	35
2020	34	35	30	5	0
Total	147	85	30	5	50

Burimi: AKU

Tabela 16: Lëndët vepruese dhe numri i mostrave të PMB-ve të analizuarra për vitin 2020

Lëndët vepruese PMB	Numri total i mostrave PMB-ve të testuara	Numri i mostrave të PMB-ve që nuk përputhen
<i>Dimethoate</i>	8	2
<i>Abamectin</i>	4	1
<i>Chlorpyrifos</i>	3	1
<i>Hydroxide bakri</i>	1	1
Total	16	5

Burimi: AKU

Konkluzioni: Gjatë kontrolleve zyrtare të kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në njësitë e tregtimit me pakicë dhe shumicë të PMB-ve, janë konstatuar PMB-të që nuk plotësojnë kërkesat ligjore si: afati i përdorimit të tejkaluar/skaduar ose PMB-të e peregjistruara në Shqipëri, të cilat janë të bllokuara në sasi totale prej 1.3 ton dhe 1271.1 litra, për vitet 2017-2020.

Bllokimi i PMB-ve prej vitesh për mosndjekje të procesit të asgjësimit të tyre ⁵ sipas kërkesave të nenit 25 të ligjit nr.105/2016, datë 27.10.2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, mbetet një shqetësim serioz për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

4.5. Mbledhja e të dhënave

Rregullat e përgjithshme për mbledhjen e të dhënave për PMB-të janë të përcaktuara në ligjin bazë nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar. Neni 26 i këtij ligji përcakton se “Instituti i Statistikave (INSTAT), në bashkëpunim me Ministrinë, jep të dhëna statistikore për PMB-të, çdo vit për sasi të hedhura në treg dhe çdo pesë vjet për sasi të përdorura. Rregullat e sigurimit të të

⁵ Largimi i PMB-ve nga territori i Republikës së Shqipërisë ose djegia (incenerimi) e PMB-ve nga organe të specializuara për këtë qëllim, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndotjen e mjedisit.

dhënave statistikore të PMB-ve përcaktohen me marrëveshje mirëkuptimi midis Institutit të Statistikave dhe ministrisë së bujqësisë.

Aktualisht, Instituti i Statistikave nuk publikon të dhëna për PMB-të, siç specifikohet. Ky institut publikon të dhëna për importin dhe eksportin e “produkteve kimike” në përgjithësi, por pa përmendur asnjë të dhënë për PMB-të. Raportet e Ministrisë së Bujqësisë për sasinë e PMB-ve të përdorura, zakonisht i referohen të dhënave të FAO-s.

Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave të regjistrimit, procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar, struktura përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në Ministri, AKU dhe komisioni i regjistrimit të PMB-ve, publikon listën e PMB-ve të regjistruara në website zyrtar të Ministrisë dhe AKU, sa herë që ndryshon, në mënyrë që të jetë e aksesueshme për të gjithë individët apo grupet e interesit.

Për sa i përket mbledhjes së të dhënave, monitorimit të treguesve dhe kontrollit të zbatimit të masave, apo afateve për zbatimin e Planit të Veprimit për Përdorimin e Qëndrueshëm të PMB-ve, aktualisht nuk ka një organ zyrtar përgjegjës të përcaktuar në nivel kombëtar.

Ministria duhet të jetë në gjendje të përdorë të dhënat statistikore për të llogaritur treguesit e rrezikut të mbledhur në përputhje me rregulloret kombëtare dhe të BE-së, në lidhje me statistikat për produktet e mbrojtjes së bimëve, së bashku me të dhëna të tjera përkatëse. Gjithashtu, duhet të identifikohen tendencat në përdorimin/shitjen e disa substancave aktive.

Shqipëria nuk ka një qendër kombëtare toksikologjie. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike i “Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza”, merret me urgjencat që lidhen me helmimet akute nga pesticidet. Megjithatë, ky shërbim nuk zotëron funksionet e nevojshme për një qendër toksiciteti, si disponueshmëria dhe aksesin në informacionin e duhur në kohë reale në rastet e helmimeve akute.

4.6. Gjurmimi në tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve

Referuar ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve” të ndryshuar, gjurmueshmëria përcaktohet në të gjitha nivelet e prodhimeve të kulturave bujqësore me risk dhe në objektet që lidhen me PMB-të, të cilat janë ose pritet të jenë të lidhura me shëndetin e bimëve, në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së tyre.

Kultivuesit e bimëve dhe tregtarët e PMB-ve krijojnë një sistem për mirembajtjen e bazes së të dhënave, dhe procedurat e garancisë, të cilat mundësojnë identifikimin e tyre në çdo kohë. Nëpërmjet këtyre të dhënave mund të identifikohet çdo person juridik që tregton PMB.

Kultivuesit dhe tregtarët e bimëve, si dhe tregtarët e PMB-ve, e ruajnë informacionin e përmendur në këtë nen për tre vjet dhe ia japin këtë informacion AKU-së dhe ministrit, me kërkesë të tyre.

Realizimi i gjurmimit të PMB-ve bëhet sipas “regjistrit të përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) në fermë”, modeli i të cilit është miratuar së fundmi me urdhër të ministrit nr. 275 datë 14.06.2022.

Elementet kryesore të regjistrit të përdorimit të PMB-ve në fermë që lidhen me gjurmueshmërinë janë si vijon:

- Kodi i fermës;
- Dhe të dhënat e përgjithshme të fermerit, që përfshin emri dhe mbiemri i fermerit/subjektit, kodin e fermës/NIPT/NUIS, bashkinë, fshatin, pronësinë/përdorimin e tokës bujqësore, zonën kadastrale.

- Institucionet autorizuese dhe zbatuese, janë: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve si dhe Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Mënyra e plotësimit të regjistrit të përdorimit të PMB-ve në fermë.

Plotësimi i regjistrit të përdorimit të PMB-ve në fermë kryhet nga vetë prodhuesi (fermeri), i cili këshillohet nga specialistët e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësore.

Prodhimi, shpërndarja dhe kontrolli i mbajtjes së regjistrit të përdorimit të PMB-ve në fermë kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve si dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësore.

Fermerët duhet të plotësojnë tabelën që përmban të dhënat e mëposhtme:

- Bimën;
- Sipërfaqjen totale e mbjellë (dynym);
- Parcela/t, numri kadastral/pasurisë;
- Nr. Trajtimit;
- Arsyejen e përdorimit/Dëmtuesi;
- Fazën fenologjike e bimës;
- Emrin tregtar i PMB-së dhe lënda vepruese;
- Blerë nga: (shoqëruar me faturë);
- Sipërfaqjen e trajtuar (dy);
- Dozën e përdorur;
- Datën e trajtimit;
- Karencën;
- Të dhënat për produktin (data e vjeljes, shitur tek, sasia në kg);
- Shënime (nëse ka).

4.7. Monitorimi i mbetjeve të pesticideve

Në kuadrin e kërkesave të Strategjisë Tematike të BE-së për Përdorimin e Qëndrueshëm të Pesticideve, Shqipëria ka punuar për të krijuar një sistem gjithëpërfshirës për vlerësimin e rrezikut për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, që vjen nga përdorimi i PMB-ve në produktet bujqësore në

territorin e Shqipërisë, në mënyrë që të minimizohen mbetjet e pesticideve në bimë dhe produkte bimore, produkte shtazore, tokë, ujë dhe në mjedis më të gjerë.

Përfitimet e monitorimit të mbetjeve të pesticideve janë:

- Parandalimi ose zvogëlimi i rrezikut për njerëzit në rast se sasia e mbetjeve të pesticideve tejkalon NMM-të;
- Krijimi i një baze të dhënash për rastet kur mbetjet e pesticideve në ushqime në treg tejkalojnë NMM-të, gjë që mund të ndihmojë në identifikimin e tendencave në përdorimin ose keqpërdorimin e pesticideve dhe identifikimin e shkaqeve;
- Marrja e informacionit në lidhje me përdorimin e PMB-ve sipas udhëzimeve në etiketa dhe praktikave të mira bujqësore; si dhe
- Gjenerimi i informacionit për përdorimin e paligjshëm të PMB-ve.

Në bazë të Rregullores 396/2005 për nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ose mbi ushqimet me origjinë bimore, të ndryshuar, është miratuar Udhëzimi nr. 11, datë 10.5.2021, “Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në fruta, perime, të freskëta dhe/ose fara të përpunuara”, i cili ka shfuqizuar Udhëzimin nr. 5, datë 14.5.2014 “Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në banane, domate, grurë, kastravec, mollë, patate, rrush tryeze, rrush vere, spec i kuq, ullinj tryeze”, dhe Udhëzimin nr. 2, datë 14.2.2017 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 5, datë 14.5.2014 për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në banane, domate, grurë, kastravec, mollë, patate, rrush tryeze, rrush vere, spec i kuq, ullinj tavoline”. Për produktet ushqimore me origjinë shtazore zbatohet Udhëzimi nr. 5, datë 7.09.09 “Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore me origjinë shtazore”.

Nga viti 2017 e në vazhdim⁶, me udhëzim të ministrit, një nga masat e marra për arritjen e qëllimit të përbashkët, ishte hartimi dhe miratimi i “Planit të Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve në produktet me origjinë bimore”. Në kuadër të këtij plani, AKU, nëpërmjet drejtorive rajonale të saj, kryen kampionime të produkteve bimore, të cilat dërgohen në ISUV për analiza të mbetjeve të pesticideve. Rezultatet e analizave që tejkalojnë NMM-të raportohen në MBZHR dhe një kopje dërgohet tek AKU. Drejtorja e Vlerësimit të Riskut e AKU-së, njofton Drejtorinë Rajonale përkatëse të AKU-së dhe një kopje të dokumentit ia dërgon për informim Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollave Zyrtare për marrjen e masave të duhura sipas legjislacionit. MBZHR-ja është institucioni që mbikëqyr procesin.

Problemtika 1: Mos kthimi në kohë i përgjigjeve së analizave nga ISUV për mostrat në bimë dhe produkte bimore/fruta -perime të marra dhe dërguara nga AKU për praninë e mbetjeve të PMB-ve.

Konkulzioni: Ndër vite, bazuar në planin e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, AKU ka marrë mostra të bimëve apo produkteve bimore (të prodhuara në vend dhe të importuara) në treg, pika grumbullimi, njësi tregtare dhe supermarkete në të gjithë vendin. Rezultatet e testeve të mostrave të marra në bazë të planit të monitorimit apo mostrave të produkteve bimore të destinuara për

eksport, kanë treguar se në bimë dhe produkte të ndryshme bimore, ka pasur raste kur përmbajtja e mbetjeve të pesticideve ka tejkaluar kufijtë e përcaktuar (normat e lejuara). Prania e mbetjeve të pesticideve është konstatuar kryesisht në mostrat e domateve, spinaqit, marules jeshile, patateve, trangujve, specave, karotave, pjeshkës, nektarinave, mollëve, luleshtrydheve dhe pjeprit.

Në ngarkesat e eksportuara janë gjetur në specat, domate, nektarina, luleshtrydhe dhe mollë.

Vonesa në marrjen e përgjigjeve të analizave ose mosmarrja e përgjigjet e analizave nga laboratorit ISUV mbetet shqetësuese, pasi zvogëlon efektivitetin e marrjes së masave të duhura në garantimin e sigurisë ushqimore për të ndjekur gjurmimin nga njësitë tregtare ose vendi i grumbullimit, të fermerit prodhues.

AKU kryen çdo vit analizën vjetore të veprimtarisë së saj, e cila pasqyron informacionin për zbatimin e planit të monitorimit të mbetjeve të pesticideve, i cili i dërgohet zyrtarisht MBZHR-së.

5. OBJEKTIVAT, SYNIMET, MASAT DHE AFATET PËR TË REDUKTUAR RREZIQET DHE NDIKIMET E PËRDORIMIT TË PMB-ve NË SHËNDETIN E NJERIUT DHE MJEDISIN

Ky Plan Veprimi, synon të përcaktojë objektiva, masa dhe tregues për të reduktuar rrezikun që rezulton nga përdorimi i PMB-ve dhe ndikimet e këtyre produkteve në shëndetin e njeriut dhe mjedisin, me theks të veçantë në menaxhimin e integruar të dëmtuesve, si dhe qasjet alternative të mbrojtjes së bimëve dhe teknikat për të reduktuar përdorimin e PMB-ve.

5.1 Objektivat e përgjithshme

Objektivi i përgjithshëm i këtij Plani Veprimi është të sigurojë një kuadër strategjik për aktivitetet që synojnë të arrijnë në Shqipëri, si vijon:

1. minimizimin e rrezikut për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve dhe mbrojtja e mjedisit nga përdorimi i PMB-ve, duke përfshirë zëvendësimin e lëndëve vepruese të rrezikshme me alternativa më të sigurta (përfshirë ato jokimike);
2. reduktimin e niveleve të mbetjeve të lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve në ushqim dhe në ujë të pijshëm, duke përfshirë zëvendësimin e atyre më të rrezikshmeve me alternativa më të sigurta (përfshirë ato jokimike);
3. inkurajimin e përdorimit të parimeve të menaxhimit të integruar të dëmtuesve në prodhimin bujqësor, në mënyrë që PMB-të të përdoren vetëm kur është e nevojshme ose e justifikuar ekonomikisht, veçanërisht duke rritur ndërgjegjësimin e përdoruesve për përdorimin e sigurt të PMB-ve, duke nxitur zhvillimin dhe futjen e bujqësisë organike dhe praktikave të tjera të qëndrueshme bujqësore;
4. zhvillimin e një sistemi transparent për raportimin dhe monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të strategjisë tematike, duke përfshirë zhvillimin e treguesve të duhur;
5. përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve në prodhimin e të gjitha bimëve, veçanërisht në kulturat prioritare, së bashku me minimizimin e rrezikut nga përdorimi i tyre.

Objektivat e detajuara janë të specifikuara në këtë plan veçmas për çdo fushë teknike përkatëse dhe janë paraqitur në seksionet përkatëse.

Në përzgjedhjen e masave për arritjen e objektivave të Planit të Veprimit janë marrë parasysh ndikimet ekonomike, sociale, mjedisore dhe shëndetësore, si dhe kriza aktuale ekonomike dhe financiare, prandaj dhe politikat dhe sistemet bujqësore të ngritura tashmë, janë përfshirë në këtë Plan. Masat jokimike, të cilat kanë përparësi në bujqësinë e integruar dhe organike, janë zakonisht më të shtrenjta ose më pak efektive se masat kimike. Prandaj, për të arritur objektivat dhe për të ruajtur aftësinë konkurruese të produkteve ushqimore, në të njëjtën kohë duhet kushtuar vëmendje se si kjo manifestohet në ekonominë prodhuese, gjë që kërkon një analizë ekonomike gjithëpërfshirëse.

Masat që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e PMB-ve në nivel njësie bujqësore, përfshijnë parimet e përgjithshme të menaxhimit të integruar të dëmtuesve të referuar në VKM Nr.317, datë 15.5.2019. Institucionet kompetente ofrojnë të gjitha mjetet, informacionin dhe këshillat në dispozicion për zbatimin rigoroz të parimeve të përgjithshme.

5.2 Trajnimi, shitja e PMB-ve, informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit

5.2.1 Trajnimi

Situata aktuale:

Trajnimi profesional për përdoruesit e PMB-ve të rrezikshme, helmuese dhe shumë helmuese në Shqipëri, bazohet në VKM-në nr.317, datë 15.5.2019 “Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve dhe kriterëve të kualifikimit për përdoruesit”, të ndryshuar. Përgatitja dhe instruktimi i personave që kërkojnë të pajisen me dëshmi aftësie bëhet në institucionet publike ose private, të miratuara sipas legjislacionit për arsimin e formimit profesional.

Para daljes së VKM-së të sipërcituar ish -Agjensitë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve sot DRVMB e kanë ofruar këtë shërbim dhe kanë pajisur me dëshmi aftësie fermerët që kanë kërkuar të trajnohen dhe të pajisen me dëshmi aftësie për përdorimin e PMB-ve. Me daljen e VKM-se në maj të 2019 nuk ka pasur pajisje me dëshmi aftësie pasi trajnimet bëhen në institucionet publike ose private.

Për sa i përket trajnimit për përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, ende nuk ka subjekte private të licencuara për formimin profesional për të ofruar këtë trajnim sipas kriterëve të përcaktuara për përdoruesit dhe përmbajtjes së programit të referuar në shtojcën 1, të VKM-së nr.317, dt. 15.5.2019. Ministria nuk e ka bërë ende të detyrueshëm këtë aktivitet, e as tarifat dhe buxhetet përkatëse nuk janë përcaktuar.

Përsa i përket sektorit publik të formimit profesional, rezulton se në 10 Drejtorite Rajonale të Formimit Profesional Publike që operojnë në të gjithë vendin, ky trajnim specifik ende nuk ofrohet.

Referuar kohë zgjatjes së programit të parashikuar 30/40 orë teori dhe 10/20 ore praktikë për trajtimin e tematikave të mësipërme me qëllim që ky trainim të jetë pjeseë e paketës së kurseve afatshkurtëra që ofrohen në keto drejtori për punë kërkuesit apo për të gjithë të interesuarit, është e mundur që zgjidhja të trajtohet në dy nivele:

-në nivel ofruesi (rajonal) që do të thotë se kërkesa për hapjen e këtij kursi duhet të ndjekë protokollin e hapjes së një kursi të ri, i cili tashmë është i mundur për të formalizuar dhe standardizuar procesin, që nga identifikimi i kërkesave (në këtë rast fermerët për pajisje me dëshmi të kompetencës për të përdorur produkte për mbrojtjen e bimëve) për të programuar zhvillimin dhe planifikimin e burimeve njerëzore paraprakisht.

-në nivel kombëtar kërkesa për këtë kurrikul duhet t'i drejtohet Agjencisë Kombëtare të Arsimit Profesional dhe Planprogramit, në mënyrë që kurrikula të miratohet në nivel qendror nga MFE-ja për përdorim nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik.

Objektivi:

Objektivi i Shqipërisë është të krijojë një sistem trajnimesh të detyrueshme për PMB-të për stafin e kompanive të përfshira në tregtinë e tyre, për konsulentët për përdorimin e PMB-ve dhe për përdoruesit profesionistë të PMB-ve, i cili do të zëvendësonte sistemin aktual të certifikatave të trajnimit dhe certifikatave speciale të trajnimit. Niveli i rritur i njohurive të stafit tregtar dhe përdoruesve profesionistë të PMB-ve, do të kontribuojë në reduktimin e rreziqeve të lidhura me PMB-të.

Synimi:

Për të arritur synimin janë vendosur objektivat e mëposhtëm.

Deri në vitin 2025, të krijohet ose përditësohet sistemi ligjor për trajnimet e detyrueshme për PMB-të dhe përdorimin e tyre, duke përfshirë rikategorizimin e PMB-ve, ripërcaktimin e “përdoruesve profesionistë”, dallimin midis PMB-ve për përdoruesit profesionistë dhe PMB-ve për përdoruesit joprofesionistë, parimet e përgjithshme të trajnimeve të detyrueshme për përdorimin e PMB-ve dhe caktimin e një organi zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e sistemit, së bashku me kompetencat e tij, etj.), si dhe aktet nënligjore që parashikojnë kërkesa të detajuara për sistemin, si kohëzgjatja e trajnimit dhe programeve, kërkesat për trajnuesit, objektet e trajnimit, pajisjet e trajnimit, materialet e trajnimit që do të përdoren, dokumentacioni dhe regjistrimi, etj.

Deri në vitin 2026, të rritet ndërgjegjësimi i përdoruesve profesionistë të PMB-ve, konsulentëve dhe stafit tregtar, si dhe kompanive që mund të jenë të interesuara të lejohen t'u ofrojnë atyre kurse trajnimi.

Duke filluar nga viti 2025, të miratohen institucionet publike ose private, sipas legjislacionit për arsimin dhe formimin profesional në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse në këtë fushë të

kryejnë trajnime për stafin e shitjeve, konsulentët dhe përdoruesit profesionistë të PMB-ve; numri i pritshëm i ofruesve të trajnimit të autorizuar: deri në 2025, deri në 2027, deri në 2032.

Përdorues profesionistë të PMB-ve, konsulentë dhe staf tregtar të trajnuar për PMB dhe rrezikun e tyre; pjesa e pritshme e stafit të trajnuar të shitjeve: deri në vitin 2027-70%, deri në 2032-90%, konsulentë: deri në vitin 2027-50%, deri në 2032-100%; përdoruesit profesionistë: deri në vitin 2027-30%, deri në 2032-50%.

Deri në vitin 2025, të zhvillohet një sistem i mbikëqyrjes së trajnimeve të organizuara nga institucioni përgjegjës sipas fushës.

Treguesit:

Shkalla në të cilën do të jetë arritur objektivi, do të verifikohet nga organi zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e tregtisë dhe aplikimin e PMB-ve, në kuadër të aktiviteteve të tij të rregullta të kontrollit. Për të matur progresin, do të përdoren treguesit e mëposhtëm:

Aktet ligjore për trajnimet e detyrueshme për PMB-të, të miratuara dhe në fuqi;

Numri dhe lloji i aktiviteteve ndërgjegjësuere të nisura;

Numri i ofruesve të autorizuar të trajnimit;

Numri/përqindja e përdoruesve profesionistë të trajnuar, konsulentëve dhe stafit tregtar;

Numri/përqindja e trajnimeve të mbikëqyrura në një vit nga organi zyrtar përkatës.

Masat:

Masat e mëposhtme janë planifikuar për të arritur objektivin:

Masa 1: Dispozitat themelore ligjore për trajnimet e detyrueshme për PMB-të do të miratohen nga MBZHR-ja.

Masa 2: Aktet nënligjore do të zhvillohen gjatë procesit legjislativ të ligjit bazë dhe do të hyjnë në fuqi me miratimin e ligjit bazë.

Masa 3: Një fushatë ndërgjegjësimi për ofruesit e mundshëm të trajnimit; Institucionet publike dhe konsulentët individualë, tregtarët e PMB-ve, konsulentët dhe përdoruesit profesionistë të PMB-ve, do të hapet me miratimin e legjislacionit bazë (organizimi i të paktën një konferencë kombëtare), prezantime të bëra në mbledhjet lokale (të paktën një në çdo prefekturë), materialet e avokimit (mëeshtetjes) të shpërndara në të gjitha rastet, përfshirë edhe gjatë kontrolleve zyrtare.

Masa 4: Ofruesit e trajnimit do të licencohen.

Masa 5: Do të zhvillohet një sistem kontrolli për zhvillimin e kurseve të trajnimit, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimeve ligjore.

5.2.2 Shitja e PMB-ve

Objektivi:

Shitja e PMB-ve, nga shitësit me shumicë dhe pakicë, bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin bazë kombëtar dhe akte të tjera nënligjore, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, të kafshëve dhe bimëve, si dhe të mjedisit.

Stafi i kompanive të shitjes së PMB-ve, do të duhet t'i nënshtrohet një trajnimi për PMB-të dhe të pajiset me certifikata trajnimi. Stafi i trajnuar do duhet të jetë i disponueshëm në momentin e shitjes për të informuar blerësit/klientët për rreziqet nga përdorimi i PMB -ve, si dhe për mënyrat për të minimizuar ato rreziqe.

Sistemi i testimit laboratorik të cilësisë së PMB-ve në treg, do të përmirësohet. Do të bëhet gjithashtu një analizë e plotë mbi arsyet e vonesave dhe mungesës së rezultateve të analizave cilësore laboratorike të mostrave të PMB-ve, do të formulohen konkluzione dhe do të adresohen boshllëqet e mundshme p.sh. përmes rritjes së kapacitetit të laboratorit për të testuar më shumë mostra ose përmirësimit të procedurave të tij të brendshme për gjurmimin e mostrave. Mbikëqyrja e laboratorit do të forcohet, në mënyrë që asnjë mostër të mos mbetet e patestuar dhe rezultatet e testimit të merren dhe të komunikohen siç përcaktohet me ligj.

Synimi:

Rritja me 30% e numrit të kontrolleve zyrtare, bazuar në planet e veprimit, dhe rritja e efektivitetit të zbulimit dhe eliminimit të praktikave abuzive dhe të paligjshme në shitjen e PMB-ve.

Një skemë nxitëse do të merret në konsideratë për inspektorët që zbulojnë mospërputhje në tregtimin e PMB-ve.

Rritja me 25% e kapaciteteve laboratorike për kryerjen e analizave të mostrave të PMB-ve të disponueshme në treg.

Ndryshimi i ligjit bazë për mbrojtjen e bimëve si dhe rishikimi i akteve të nevojshme nënligjore për shitjen e PMB-ve, do të bëhet deri në vitin 2025.

Ulja me të paktën 25% e numrit të rasteve kur subjektet e përfshirë në shitjen e PMB-ve veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Treguesit:

Numri i kontrolleve/inspektimeve të kryera në një vit

Numri i mospërputhjeve dhe numri i masave ndëshkimore/gjobave, të vendosura nga institucionet përgjegjëse në një vit

Numri i mostrave të PMB-ve të patestuara pavarësisht dorëzimit të tyre në laborator në një vit

Periudha kohore nga dorëzimi i një mostre në laborator, deri në dorëzimin e rezultatit të analizës

Numri i akteve ligjore të rishikuara ose të hartuara së fundmi

Masat:

Masa 1: Rritja e numrit të kontrolleve zyrtare nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në tregtinë me shumicë dhe pakicë të PMB-ve bazuar në plane veprimi.

Masa 2: Trajnimi i stafit të njësisve tregtare për kriteret dhe rregullat e kërkuara në tregtimin e PMB -ve.

Masa 3: Forcimi dhe rritja e kapaciteteve laboratorike për analiza cilësore të PMB-ve.

Masa 4: Ndryshimi i Ligjit/VKM-së, për rishikimin e rregullave për dhënien e recetave për përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Masa 5: Mekanizmi i Veprimit (MeV) sipas: FRAC, IRAC, HRAC, etj., duhet të shtohet në etiketat e reja të PMB-ve, për të kontrolluar përdorimin e PMB-ve si dhe për të reduktuar fenomenin e rezistencës.

Masa 6: MBZHR-ja dhe strukturat e saj vartëse (AKU, AKVMB), duhet të zbatojnë metodologjinë për vlerësimet e nevojshme të tendencave në Treguesit e Harmonizuar të Riskut 1 dhe 2.

5.2.4 Rritja e informacionit dhe ndërgjegjësimit

Situata aktuale:

Sipas pikës 16 të kreut III: “Kriteret e kualifikimit të përdoruesit dhe informacionit” të VKM-së nr. 317 datë 15.5.2019, MBZHR-ja merr masa për të promovuar dhe lehtësuar programet e informimit dhe ndërgjegjësimit, për të siguruar disponueshmërinë e nje informacioni te kujdeshem dhe te balancuar per publikun e gjerë, në lidhje me PMB-të, veçanërisht sa i përket rreziqeve dhe efekteve të mundshme akute dhe kronike në shëndetin e njeriut, organizmave jo të synuar dhe mjedisit, si dhe mbi përdorimin e alternativave jokimike.

Në këtë VKM (Kreu III, pika 15) janë parashikuar masa për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit për episodet e helmimit nga PMB-të, si dhe helmimet e mundshme kronike nga këto produkte në grupe që mund të ekspozohen rregullisht, si operatorët, punëtorët e bujqësisë ose popullsia pranë zonave të trajtimit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për mbledhjen e këtij informacioni.

Trajtimi i kontejnerëve të zbrazët të PMB-ve pas përdorimit, është rregulluar tashmë nga një rregullore që përcakton detyrimet e personave që dërgojnë ose furnizojnë PMB të paketuara për përdorim përfundimtar direkt tek përdoruesit e fundit, për të informuar publikun e gjerë në lidhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve PMB në pikat e shitjes ose pikat e grumbullimit të mbetjeve të PMB-ve. Mbledhësit e mbetjeve të PMB-ve, janë të detyruar të informojnë përdoruesit e fundit të PMB-ve dhe publikun për qëllimin dhe objektivat e grumbullimit të ambalazheve e zbrazët të PMB-ve, opsionet e grumbullimit falas, si dhe metodat e riciklimit dhe asgjësimit të ambalazheve të zbrazët të PMB-ve.

Krijimi i sistemit të trajnimit do të luajë një rol vendimtar në ndërgjegjësimin e njerëzve të përfshirë në linjën e shpërndarjes së PMB-ve, si dhe për përdoruesit profesionistë të PMB-ve.

Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të përdoruesve, do të përcaktohet në Aktin e ri të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, përmes së cilit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, do të prezantojë një program ndërgjegjësimi që përfshin masa për të promovuar dhe lehtësuar informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik në lidhje me ndikimin e mundshëm në shëndetin e njeriut, organizmat jo të synuar dhe mjedisin e përdorimit jo të duhur të PMB-ve, si dhe trajtimin jo të duhur të ambalazheve të zbrazët të PMB-ve dhe mbetjeve të PMB-ve që rezultojnë nga trajtimi (pajisje mbrojtëse personale të ndotura, solucione PMB që mbeten pas trajtimit).

Objektivi:

Fuqizimi i përdoruesve të PMB-ve dhe i publikut me njohuri dhe ndërgjegjësim mbi rreziqet e mundshme të PMB-ve për shëndetin e njeriut, speciet dhe mjedisin jo të synuar dhe mbi mënyrat për t'i minimizuar këto rreziqe.

Synimi:

Publikimi i rregullt i të dhënave për hedhjen në treg dhe përdorimin e PMB-ve (një herë në vit), duke filluar nga viti 2023.

Publikimi i raporteve periodike për mbetjet e pesticideve në ushqim dhe në ujën e pijshëm, të aksesueshme për popullatën e përgjithshme.

Publikimi dhe shpërndarja të paktën çdo dy vjet e materialeve të përditësuara ndërgjegjësuese mbi aspekte të ndryshme të ekspozimit dhe efektet e mundshme të PMB-ve në shëndetin e njeriut, me theks të veçantë në grupet e cenueshme, dhe në speciet dhe mjedisin jo të synuar, si dhe në mënyrat për të minimizuar efektet negative, duke synuar gjithashtu popullatën e përgjithshme dhe përdoruesit joprofesionistë.

Treguesit:

Numri i raporteve vjetore mbi shitjet dhe përdorimit të PMB-ve, të botuara ndërmjet viteve 2023 dhe 2032

Numri i raporteve/buletineve periodike mbi mbetjet e pesticideve në ushqim dhe në ujë, të botuar ndërmjet viteve 2023 dhe 2032;

Numri i materialeve të botuara të përditësuara ndërgjegjësuese për rreziqet që paraqesin PMB -të; Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara, që synojnë popullatën e përgjithshme dhe përdoruesit joprofesionistë, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve vulnerabël.

Numri i konsultimeve publike dhe takimeve të hapura me pjesëmarrjen e shoqërisë civile.

Masat:

Masa 1: Publikimi i raporteve vjetore për hedhjen në treg dhe pesë vjeçare për përdorimin e PMB-ve.

Masa 2: Publikimi i raporteve vjetore për rastet e helmimeve akute dhe rastet e helmimeve kronike nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Masa 3: Publikimi i raporteve periodike, lidhur me monitorimin e mbetjeve të pesticideve në ushqim.

Masa 4: Publikimi i rezultateve të monitorimit të pesticideve në ujë në buletinet për cilësinë e ujit.

Masa 5: Fushata mediatike për rreziqet nga pesticidet dhe mënyrat për t'i minimizuar ato.

Masa 6: Përfshirja e shoqërisë civile në ndërgjegjësimin për rreziqet e PMB-ve dhe mënyrat për t'i minimizuar ato.

Masa 7: Kuadri ligjor duhet të ndryshohet (përmirësohet) dhe zbatohet siç parashikohet në Planin e Veprimit, në përputhje me legjisllacionin e BE-së për përdorimin qëndrueshëm. Informacioni mbi ndryshimet ligjore do të vihet në dispozicion në faqen e internetit të MBZHR-së.

5.3 Mbledhja e të dhënave**Situata aktuale:**

Aktualisht ka mungesë koordinimi mes institucioneve, të cilat sipas ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, ngarkohen për publikimin e të dhënave statistikore për PMB-të.

Në këto rrethana, MBZHR-ja duhet të krijojë një grup ekspertësh, për të mbledhur të dhënat ose raportet e kërkuara. Bazuar në të dhënat, raportet dhe analizat, do të përgatitet një raport vjetor për progresin e bërë në arritjen e objektivave të PV-së dhe propozimet për aktivitetet e ardhshme. Grupi i ekspertëve mund të propozojë edhe ndryshimet në PV me masa shtesë për arritjen e objektivave të këtij Plani.

Grupi i ekspertëve duhet të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të përfshira në kryerjen e aktiviteteve që lidhen me masat individuale, duke përfshirë organizatat joqeveritare.

Objektivi:

Të dhënat statistikore të lidhura me PMB-të, si tregtia, përdorimi, rastet e helmimit dhe mbetjet e pesticideve të zbuluara, mblidhen duke përdorur procedura transparente, të përcaktuara me ligj.

Të dhënat statistikore raportohen nga të gjitha subjektet përkatëse.

Të dhënat e grumbulluara vihen në dispozicion të publikut në formën e raporteve vjetore në faqet e internetit të MBZHR-së.

Synimi:

Deri në vitin 2032, të rritet në 30 % përqindja e subjekteve që raportojnë për shitjet dhe përdorimin e PMB-ve nga ana e tyre për të siguruar mbledhjen, grumbullimin dhe publikimin në kohë të të dhënave të kërkuara.

Mbledhja e të dhënave për sasinë e PMB-ve që importohen dhe përdoren në vend, duhet të bëhet sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në nenin 26 të ligjit nr. 105/216 “Per mbrojtjen e bimeve”, të ndryshuar.

Megjithatë, është i nevojshëm plotësimi i mëtejshëm i Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve me akte të tjera nënligjore, si dhe aplikimi i një metodologjie standarde për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave. Të sigurohet mbledhja efektive e të dhënave për të gjitha rastet e helmimeve akute nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Arritja e reduktimit të numrit të rasteve me 50% deri në vitin 2032, duke përdorur vitin 2022 si referencë.

Të sigurohet që të gjitha shkeljet/veprimet e paligjshme në përdorimin e PMB-ve të identifikuar gjatë planit kombëtar të monitorimit për mbetjet e pesticideve dhe rastet e kontaminimit të ujit të pijshëm, të shqyrtohen për të mundësuar veprime korigjuese. Kjo do të lehtësojë identifikimin e çdo tendence në lidhje me efektet negative shëndetësore, nëse ato ekzistojnë, dhe do të ndihmojë në përmirësimin e situatës.

Treguesit:

Numri/përqindja e subjekteve që raportojnë në kohë në INSTAT për hedhjen në treg dhe përdorimin e PMB -ve.

Numri i rasteve të regjistruara të helmimit akut me pesticide.

Numri i rasteve të niveleve të mbetjeve të pesticideve që tejkalojnë NMM-të në ushqim dhe ujë të pijshëm.

Numri i raporteve vjetore mbi tregtinë (çdo vit) dhe përdorimin (çdo 5 vjet) e PMB-ve të publikuara nga MBZHR-ja.

Masat:

Masa 1: Përmirësimi i sistemeve të vendosura për të siguruar mbledhjen, grumbullimin dhe analizën e plotë dhe të rregullt të të dhënave të shitjeve dhe përdorimit të PMB-ve, duke përfshirë informacionin mbi zbatimin e praktikave të menaxhimit të integruar të dëmtuesve në bujqësi në nivel ferme.

Masa 2: Përmirësimi i sistemeve për analizën vjetore të të dhënave për helmimet akute nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Masa 3: Përmirësimi i sistemeve për të siguruar që të gjitha tejkalimet e nivelit maksimal të mbetjeve nga plani i monitorimit të mbetjeve janë regjistruar, si edhe janë kryer vlerësimet e rrezikut të shëndetit të njeriut dhe vlerësimet e rrezikut ekotoksikologjik.

Masa 4: Ngritja e sistemeve për njoftimin e ISHP-së për tejkalimet e pesticideve në ushqim dhe ujë të pijshëm.

5.4. Pajisjet për aplikimin e PMB-ve

5.4.1 Inspektimi dhe certifikimi i pajisjeve në përdorim

Situata aktuale:

Regjistrimi, testimi dhe kalibrimi i pajisjeve spërkatëse, zvogëlon rrezikun e shpërndarjes së pabarabartë të PMB-ve në bimët e trajtuara, funksionimin e gabuar të spërkatësve duke zvogëluar ose minimizuar lëvizjen, ekspozimin e operatorëve të spërkatësve të PMB-ve dhe ekspozimin ndaj organizmave jo të synuar. Gjatë aplikimit, ato zvogëlojnë ekspozimet që mund të vijnë nga defektet e makinerive spërkatëse.

Deri në hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.317, datë 15.5.2019, inspektimi i pajisjeve për aplikimin e PMB-ve në përdorim, nuk ka qenë i detyrueshëm në Shqipëri. Ky vendim mbulon të gjitha aspektet e rëndësishme për arritjen e një niveli të lartë sigurie dhe mbrojtjeje të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit me aplikimet PMB. Efikasiteti i plotë i funksionimit të aplikimit, duhet të sigurohet nga zgjedhja e duhur e pajisjeve dhe funksionimi i duhur i tyre për të siguruar përmbushjen e objektivave të mëposhtëm.

Sipas VKM 317 datë 15.5.2019, pajisjet e aplikimit PMB duhet të funksionojnë në mënyrë të besueshme dhe të përdoren siç duhet për qëllimin e synuar në mënyrë që PMB-të të mund të përdoren me saktësi. Pajisja duhet të jetë në gjendje të tillë që të mund të mbushet dhe zbrazet në mënyrë të sigurt, lehtësisht dhe plotësisht dhe të parandalojë rrjedhjen e PMB-ve. Ajo duhet të lejojë pastrim të lehtë dhe të plotë. Gjithashtu duhet të sigurojë operime të sigurta dhe të kontrollohet dhe ndalohet menjëherë nga ana e operatorit. Kur është e nevojshme, rregullimet duhet të jenë të thjeshta, dhe të sakta.

Në VKM 317 datë 15.5.2019, parashikohet të verifikohet nëse pajisjet për aplikimin e PMB-ve plotësojnë kërkesat, për arritjen e nivelit të lartë të mbrojtjes për shëndetin e njeriut dhe mjedisit. Parashikohet që pajisjet e reja për aplikimin e PMB-ve duhet të jenë në përputhje me standardet e harmonizuara me legjislacionin për standardet dhe rregulloret teknike. Inspektimi i pajisjeve të aplikimit PMB, duhet të mbulojë të gjitha aspektet e rëndësishme për të arritur një nivel të lartë sigurie dhe mbrojtjeje të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit. Efikasiteti i plotë i funksionimit të operacionit të aplikimit, duhet të sigurohet nga përzgjedhja e duhur e funksioneve të aparaturave dhe pajisjeve për të siguruar arritjen e objektivave, sipas vendimit. Pajisjet për aplikimin e PMB-ve në përdorim, i nënshtrohen inspektimit të rregullt të paktën një herë në tre vjet. Deri më tani, nuk ka nisur kontrolli i certifikimit të pajisjeve për aplikimin e PMB -ve.

Objektivi:

Te sigurohemi që pajisjet në përdorim profesional për aplikimin e PMB-ve, të regjistrohen dhe të inspektohen në intervale të rregullta, në mënyrë që të arrihet niveli i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit.

Synimi:

Deri në vitin 2024, të miratohen rregullore që vendosin procedurat dhe rregullat për kontrollin e pajisjeve të aplikimit PMB në përdorim.

Deri në vitin 2027, të gjitha pajisjet me motor për spërkatje dhe deri në vitin 2029 të gjitha pompat e spërkatjes duhet të regjistrohen.

Deri në vitin 2032, duhet të jetë verifikuar plotësimi i kriterëve teknike dhe funksionimi i të paktën 85% i të gjitha pajisjeve të aplikimit të PMB-ve të përdorura nga përdoruesit profesionistë të PMB-ve, me rekomandime për pronarët dhe afate për përmbushjen e tyre.

Pajisjet për aplikimin e PMB-ve duhet të kontrollohen të paktën një herë brenda vitit 2025. Pajisjet e reja do të kontrollohen një herë në 5 vjet.

Treguesit:

Numri i pajisjeve spërkatëse të regjistruara

Numri i subjekteve të autorizuar, sipas prefekturave.

Numri i pajisjeve të aplikimit PMB të kontrolluara.

Përqindja e pajisjeve të aplikimit PMB në përdorim, që plotësojnë kërkesat ligjore.

Masat:

Masa 1: Përpilimi dhe mbajtja e një regjistri të pajisjeve për aplikimin e PMB.

Masa 2: Caktimi i një organi zyrtar përgjegjës për kontrollin e pajisjeve të aplikimit PMB. Vendosja e procedurave për autorizimin e inspektorëve për të kontrolluar pajisjet e aplikimit të PMB-ve.

Masa 3: MBZHR-ja do të autorizojë subjektet për të kontrolluar/testuar mjetet spërkatëse dhe për të mbikëqyrur aktivitetin e tyre

Masa 4: MBZHR-ja do të përcaktojë kërkesat për testimin e pajisjeve dhe trajnimin e stafit në subjektet që do të autorizohen

Masa 5: MBZHR-ja do të përcaktojë procedurën e testimit, çfarë dhe si do të testohet

Masa 6: MBZHR-ja do të kryejë një fushatë ndërgjegjësimiti për të përcjellë mesazhin për testimin e pajisjeve spërkatëse tek subjektet e mundshme të testimit dhe te pronarët e pajisjeve të aplikimit të PMB-ve.

5.4.2. Praktikrat dhe përdorimet specifike të PMB-ve

a) Aplikimi ajror

Për shkak të copëzimit të tokës bujqësore dhe modelit të vendbanimeve në Shqipëri, spërkatja e sigurt me aeroplan nga ajri me PMB, nuk është e mundur; prandaj, aplikimi i PMB-ve me aeroplan është i ndaluar.

Masa: Nuk nevojiten masa të mëtejshme.

5.5 Mbrojtja e organizmave jo të synuar, mjedisit ujor dhe ujit të pijshëm

Situata aktuale:

Mbrojtja e mjedisit ka një rëndësi të madhe për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm njerëzor, pasi është nën kërcënimin e industrializimit kimik që çon në një çlirim të lartë të kimikateve helmuese. PMB-të, për shkak të përdorimit të tyre të gjerë, mund të zbulohen në tokë, ujë, sediment, ajër, florë dhe faunë. Përdorimi i gjerë dhe i pakontrolluar i PMB-ve, kontribuon në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit. Prania e pesticideve në mjedis ndikon drejtpërdrejt të gjithë organizmat e gjallë, duke shkaktuar dëme të diversitetit biologjik.

Si vend kandidat për në BE, Shqipëria ka nisur procesin e transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e saj kombëtar. Në fushën e mbrojtjes së mjediseve ujore, fokusi është në krijimin e një kuadri të ri legjislativ dhe institucional për mbrojtjen e natyrës duke marrë parasysh Direktivën e Këshillit 92/43/KEE për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër. Në Shqipëri, mbrojtja e tyre në parim garantohet nëpërmjet ligjit nr. 10431, datë 14.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 5 i të cilit përcakton se “ruajtja e diversitetit biologjik është një nga elementet kryesorë mjedisorë”.

Më tej ka disa akte ligjore që garantojnë mbrojtjen e natyrës si: Ligji nr. 9587 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, ndryshuar me ligjin nr. 68/2014; Ligji Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”⁸ etj. Për të garantuar zbatimin e këtyre ligjeve, janë nxjerrë një sërë aktesh nënligjore për të plotësuar bazën ligjore për elemente të veçantë të mbrojtjes së natyrës. Kështu, VKM Nr. 31, datë 20.01.2016 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike të Mbrojtjes së Mjedisit

⁸ “Zonat e mbrojtura” janë sipërfaqet tokësore dhe ujore me vlerë të veçantë natyrore të florës dhe faunës, të cilat janë të mbrojtura me ligj dhe rregullore të veçanta.

(DPSMM), identifikon qartë fushat kryesore të punës, në veçanti: rritjen e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura, hartimin e Planeve të Menaxhimit dhe zbatimin e tyre; plotësimin e kuadrit ligjor, në përputhje me ligjet e BE-së për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe ekosistemeve, etj.

Plani i Veprimit për Përdorimin e Qëndrueshëm të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve mund të kontribuojë në mbrojtjen e diversitetit biologjik, veçanërisht në sektorin bujqësor. Prandaj, sfida është të zbatohen masat e përshtatshme për të ruajtur dhe nxitur diversitetin biologjik të peizazhit bujqësor, duke përfshirë organizmat e tij të dobishëm vendas, ekosistemet, habitatet dhe vendet e tërheqjes.

5.5.1. Mbrojtja e organizmave jo të synuar

Situata aktuale:

Përdorimi i PMB-ve në bujqësi për të kontrolluar dëmtuesit e bimëve mund të ketë efekte të dëmshme në organizmat jo-të synuar, duke përfshirë bletët (bletët e mjaltit, bletët e vetme dhe bletët e vogla) të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme për pjalmimin e kulturave bujqësore, së bashku me të tjerë arthropod jo-të-synuar, mund të ndikohen nga aplikimi i pesticideve.

Sipas të dhënave të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), vlerësohet se nga 100 specie bimore që prodhojnë 90% të ushqimit në botë, 71 specie pjalmohen nga bletët. Kulturat kryesore të kultivuara në Shqipëri varen nga pjalmimi nga bletët dhe pjalmuesit e tjerë. Për më tepër, pllenimi ka gjithashtu një kontribut të pamatshëm në ruajtjen e diversitetit biologjik të bimëve. Mbrojtja e bletëve nga aplikimi i pesticideve me gjethe dhe nga farat e trajtuara, duke përfshirë masat dhe procedurat për uljen e rrezikut, duhet të përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë.

Në fakt, në Shqipëri nuk ka asnjë manual ose kod të miratuar të praktikave të mira të bletarisë që nënkupton rrezikun minimal të mundshëm për bletët në mjedisin bujqësor (p.sh. aksesit në ujë, shmangia e pozicionimit të bletëve në afërsi të zonave me rrezik helmimi për shkak të spërkatjes teknikisht jo korrekte, dialogu dhe bashkëpunimi i bletarëve me prodhuesit bujqësorë). Në kuadrin e zhvillimit të integruar rural, duhet të promovohet kërkimi mbi ndikimin e PMB-ve tek bletët për t'i mbrojtur ato. Kështu, mbrojtja e insekteve, veçanërisht e pjalmuesve dhe artropodëve të tjerë të dobishëm, është e një rëndësie të madhe në ruajtjen e biodiversitetit dhe për bujqësinë.

Për më tepër, përdorimi i gjerë dhe i gabuar i PMB-ve, mund të çojë në kontaminim të mjedisve tokësore dhe ujore, duke paraqitur rreziqe për organizmat ujorë dhe tokësorë. Të gjitha nivelet e organizmave ujorë, duke përfshirë prodhuesit kryesorë, mikroorganizmat, jovertebrorët, bimët, peshqit ose amfibët, pësojnë dëme të konsiderueshme për shkak të zhvendosjes së pesticideve në mjediset ujorë si liqene, rezervuar dhe lumenj, duke çuar në rënien e biodiversitetit ujor. PMB-të kanë ndikime të pafavorshme në speciet jo të synuara dhe ndikojnë në jetën e kafshëve dhe biodiversitetin bimor të ekosistemeve tokësore. Akumulimi i PMB-ve në zinxhirët ushqimorë, prek drejtpërdrejt insektet predatore, dhe në mënyrë indirekte, PMB-të mund të zvogëlojnë sasinë e

bimeve barishtore te egra, shkurreve dhe insekteve me të cilat ushqehen, grupet tjera të organizmave. Aplikimi i insekticideve, herbicideve dhe fungicideve, tashmë ka çuar në rënien e popullatave të disa llojeve të kafshëve dhe shpendëve.

Disa PMB, p.sh. fungicidet, mund të ndikojnë në komunitetin mikrobik të tokës, duke përfshirë kërpudhat, bakteret dhe protistët, si edhe faunën e tokës: artropodët, jovertebrorët (nematodat, krimbat e tokës), të cilët luajnë një rol vendimtar në riciklimin e lëndëve ushqyese, duke ruajtur kështu pjellorinë e tokës dhe produktivitetin bujqësor. Në Shqipëri, aktualisht nuk ka rregullore specifike që vendosin kritere apo masa për mbrojtjen e organizmave ujorë dhe tokësorë nga pesticidet dhe për këtë arsye, rekomandohet hartimi i tyre. Këto masa duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret ne fuqi, për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve.

Objektivi:

Ulja e rrezikut të PMB-ve ndaj bletëve dhe organizmave të tjerë jo të synuar (organizmat ujorë dhe tokësorë) duke hartuar dhe zbatuar një rregullore që do të vendosë kërkesat në lidhje me përdorimin e duhur të PMB-ve.

Synimi:

Pritet që deri në vitin 2032, zbatimi i rregulloreve përkatëse të ndihmojë në uljen e numrit të rasteve të helmimit të bletëve.

Sugjerohet një plan monitorimi, si dhe reduktimi i numrit të mostrave të mjaltit, me mbetje mbi NMM me 50% krahasuar me një vit më parë.

Treguesit:

Numri i analize/studimeve të kryera për vlerësimin e rreziqeve të lidhura me pesticidet mbi bletët dhe organizmat e tjerë;

Numri i rregulloreve/manualeve të hartuara në lidhje me përdorimin e duhur të PMB-ve;

Numri i mostrave të tokës dhe ujit të analizuara, qe rezultojne të kontaminuara me pesticide.

Numri i rasteve të helmimit me pesticide të bletëve, pjalmuesve të tjerë ose kafshëve të tjera.

Masat:

Masa 1: Rritja sistematike e ndërgjegjësimit për rrezikun e mundshëm të PMB-ve ndaj bletëve dhe organizmave të tjerë jo të synuar, nëpërmjet trajnimit dhe edukimit të përdoruesve profesionistë të PMB-ve.

Masa 2: Zhvillimi i një kodi të praktikës së mirë të bletarisë që do të nënkuptojë rrezikun minimal të mundshëm për bletët në mjedisin bujqësor duke nxitur dialogun dhe bashkëpunimin e bletarëve me prodhuesit bujqësorë.

Masa 3: Stimulimi i bashkëpunimit ndërmjet përdoruesve profesionistë të PMB-ve, veçanërisht prodhuesve bujqësorë, shoqatave të bletarisë dhe institucioneve të tjera të përfshira në regjistrimin

dhe hedhjen në treg të PMB-ve miqësore me mjedisin, në mënyrë që të zvogëlohen rreziqet për bletët dhe pjalmuesit e tjerë.

Masa 4: Krijimi i një sistemi monitorimi të rasteve të helmimit të bletëve me PMB në Shqipëri, nëpërmjet regjistrimit të rasteve dhe testimi të mbetjeve të pesticideve në bletët e mjaltit, me qëllim marrjen e informacionit të përditësuar mbi gjendjen dhe nivelin e mbrojtjes së bletëve dhe kolonive të bletëve nga pesticidet.

Masa 5: Krijimi i një sistemi monitorimi të mbetjeve të pesticideve në tokë dhe ujë për të marrë informacion mbi ekspozimin e organizmave ujorë dhe tokësorë ndaj pesticideve.

Masa 6: MBZHR-ja duhet të përgatisë një listë të PMB-ve më pak helmues për bletët dhe pjalmuesit e tjerë.

5.5.2. Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Situata aktuale:

Rregullorja (KE) Nr. 1107/2009 imponon një sërë kushtesh për përdorimin e PMB-ve, të tilla si zonat e detyrueshme sigurie dhe përdorimi i sprucatorve shperndares me rreze te vogel, me qëllim mbrojtjen e ujit nga ndotja me PMB. Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për mbetjet e pesticideve, duhet të kryhet sipas legjislacionit kuadër të ujit.

Lëndet vepruese të përdorura në produktet për mbrojtjen e bimëve ose metabolitët e tyre, mund të depërtojnë në ujërat nëntokësore ose sipërfaqësore nëpërmjet aplikimeve të PMB-ve të papërshtatshme, ose që nuk janë në përputhje me qëllimin e caktuar, p.sh. në sipërfaqe të forta, jo bujqesore, pranë burimeve të ujit, ose nëpërmjet pastrimit të papërshtatshëm të spërkatësve, etj.

Parandalimi ose reduktimi i depërtimit të PMB-ve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, mund të arrihet me aplikimin e masave specifike parandaluese, të cilat vazhdimisht përmirësohen dhe përshtaten me zhvillimet më të fundit në shkencë dhe teknologji. Këto masa përfshijnë aplikimin e teknologjive të përshtatshme, përcaktimin e distancave minimale nga trupat ujorë ose zonat sigurie (tampon), marrjen parasysh të vetive të shpëlarjes së PMB-ve dhe të tokës dhe kushteve klimatike, reduktimin e rrezes se përhapjes se pikave te solucionit sperkates, etj. Zonat sigurie janë një mjet i rëndësishëm për menaxhimin e rrezikut për të mbrojtur cilësinë e ujit dhe mjediset ujore. Gjatë procesit të miratimit të PMB-ve, organet kompetente duhet të sigurojnë që PMB-të e regjistruara, nëse përdoren siç duhet, nuk duhet të çojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore dhe nuk kanë nevojë të klasifikohen si të rrezikshme për mjedisin ujor.

Në Shqipëri janë në fuqi Ligjet dhe rregulloret e mëposhtme, në lidhje me cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mbrojtjen e ujit dhe monitorimin e substancave të rrezikshme në ujë:

- Ligji nr. 111/2012, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;
- VKM Nr. 246, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e standardeve të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”;
- VKM Nr. 267, datë 7.5.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore”.

Bazuar në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, duhet të kryhen masa dhe monitorime të vazhdueshme për të mbrojtur cilësinë e ujit dhe ekosistemet ujore. Në listën prioritare për monitorim, përveç disa substancave të rrezikshme, përfshihen edhe disa pesticide të rrezikshme të cilat janë aplikuar në të kaluarën apo sot, me potencial të lartë depërtimi në ujë dhe të rrezikshëm për mjedisin ujor. Megjithëse mbetjet e pesticideve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nuk monitorohen, ato duhet të bëhen pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është organi përgjegjës për monitorimin e substancave prioritare në mjediset ujore.

Objektivi:

Reduktimi i ndotjes së mjedisit ujor (sipërfaqësor dhe nëntokësor) me PMB nëpërmjet nxitjes së aplikimit të masave të duhura nga prodhuesit bujqësorë dhe nëpërmjet monitorimit zyrtar të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për pesticide.

Synimi:

Krijimi i një sistemi për monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për analizën e pesticideve në AKM, duke përfshirë një laborator të akredituar
Rritja me 50% e numrit të mostrave të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të mbledhura dhe të analizuar për mbetjet e pesticideve dhe zvogëlimi me 50% i numrit të mostrave, që rezultojnë, me mbetje të pesticideve mbi nivelet maksimale të lejuara të mbetjeve.
Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive të përdoruesve dhe konsulentëve profesionistë në lidhje me mbrojtjen e mjedisve ujorë nga pesticidet, përmes trajnimeve për pesticidet.

Treguesit:

Numri i mostrave të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, të mbledhura dhe të analizuar për mbetje pesticidesh, numri i mostrave me mbetje pesticidesh nën dhe mbi nivelin maksimal të lejuar të mbetjeve.

Numri i trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuëse lidhur me mbrojtjen e ujit nga pesticidet.

Masat:

Masa 1: Zgjerimi i bazës së njohurive dhe përmirësimi i mbrojtjes së ekosistemeve ujore nëpërmjet edukimit dhe trajnimit, ndërgjegjësimi i përdoruesve të pesticideve dhe mbështetja e futjes së sistemeve efektive të menaxhimit që marrin parasysh aspektet e mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjen e mjedisve ujorë;

Masa 2: Zbatimi i një administrimi të duhur të ekosistemit të ujit për të shmangur hyrjet e PMB-ve në ujërat sipërfaqësore nga burimet kryesore dhe burime të tjera.

Masa 3: Përfshirja e konsiderimit të rreziqeve për mjediset ujore dhe ujërat nëntokësore si kriter në procedurën e autorizimit zyrtar të PMB-ve për tregtim dhe përdorim.

Masa 4: Promovimi i metodave më efektive të përdorimit për reduktimin e rrezes së përhapjes së PMB-ve, mbështetje ajrore për spërkatës dhe atomizues, sprucator shpërndarës të përshtatshëm, si masa shtesë për zbutjen e rrezikut për mjedisin ujor dhe reduktimin e konsumit të PMB-ve.

Masa 5: Reduktimi ose eliminimi i aplikimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve në ose përgjatë autostradave, linjave hekurudhore, sipërfaqeve shumë të depërtueshme ose infrastrukturës tjetër afër ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore, ose në sipërfaqe të mbyllura me rrezik të lartë të rrjedhjes në ujërat sipërfaqësore ose në sistemet e ujërave të zeza.

Masa 6: Ndalimi i përdorimit të PMB-ve në zonat e mbrojtura, ose aplikimi vetëm me leje të posaçme.

Masa 7: Akreditimi i laboratorëve dhe akreditimi dhe validimi i metodave analitike për përcaktimin e pesticideve në ujë.

Masa 8: Monitorimi i mbetjeve të pesticideve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, për dhënien e prioritetit të substancave aktive të rrezikshme për ujin dhe organizmat ujorë.

5.5.3 Mbrojtja e ujit të pijshëm

Gjendja aktuale

Në tetor të vitit 2019 publikohet “Strategjia Kombëtare e sektorit të Ujësjiellës-Kanalizimeve 2020-2030”, e cila synon të përmirësojë ofrimin e shërbimit cilësor të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Në kuadër të objektivit specifik 3.4 “Zhvillimi dhe fuqizimi i masave për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm” të kësaj draft-strategjie, është planifikuar ndër të tjera të vendoset një sistem dhe protokoll për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e konsumatorëve, ofruesve të shërbimeve, institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe ngritja dhe funksionimi i laboratorëve rajonale për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm.

Në fushën e cilësisë së ujit, ka pasur progres drejt transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit me miratimin e Ligjit 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”. Transpozimi i Direktivës së Këshillit 98/83/KE të datës 3 nëntor 1998 për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor konsiderohet 100% i realizuar me miratimin e VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm”. Sipas VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm” ka tre hapa të monitorimit të ujit të pijshëm: monitorimi i brendshëm, i cili bëhet nga furnizuesit ose administratorët e ujit, monitorimi i jashtëm, që është përgjegjësi e strukturës rajonale të shëndetit publik dhe inspektimit. Kjo VKM përcakton zonat e mbrojtjes sanitare rreth burimeve ujore sipërfaqësore ose nëntokësore që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm, të cilat synojnë mbrojtjen e cilësisë së ujit. Zonat e mbrojtjes sanitare përcaktohen në tre nivele mbrojtëse: zona të mbrojtjes së brendshme, të ndërmjetme dhe të jashtme dhe kërkesat higjieno-sanitare për çdo nivel përcaktohen në Shtojcën VI të VKM-së.

Strukturat rajonale të shëndetit publik nuk kanë kapacitete për të kryer analiza të ujit për pesticide. Analizat e disa pesticideve kryhen në Institutin e Shëndetit Publik për burime të reja ujore përpara miratimit për ambalazhim ose për konsum njerëzor, me kërkesë të të interesuarit, i cili mbulon edhe shpenzimet.

Objektivi:

Përmirësimi i sigurisë së ujit të pijshëm nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe zbatimit të praktikave të përshtatshme dhe të qëndrueshme në përdorimin e PMB-ve.

Përmirësimi i monitorimit të jashtëm të ujit të pijshëm për pesticide.

Synimi:

Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive të përdoruesve dhe konsulentëve profesionistë të PMB-ve në lidhje me mbrojtjen e burimeve ujore nga pesticidet duke përfshirë zonat e mbrojtjes sanitare të ujit në kurrikulat e trajnimit, materialet e trajnimit dhe materialet ndërgjegjësuese,

Rritja e kapaciteteve të laboratorëve të shëndetit publik për të kryer testimin e ujit të pijshëm për pesticide, duke përfshirë rritjen e numrit të substancave aktive të analizuar dhe akreditimin sipas ISO 17025, deri në vitin 2030.

Treguesit:

Informacion mbi zonat e mbrojtjes sanitare të ujit të përfshira në kurrikulat e trajnimit dhe materialet e trajnimit për përdoruesit e PMB-ve, shitësit e PMB-ve, konsulentët.

Numri i materialeve sensibilizuese për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve, ku përfshihen edhe çështjet e mbrojtjes së ujit

Laboratori(ët) përgjegjës për analizën e pesticideve në ujë, të akredituar për analizën e pesticideve, numrin e përbërësve aktivë të analizuar

Numri/përqindja e tejkalimeve të niveleve të pesticideve në mostrat e testuara të ujit të pijshëm të identifikuar në një vit.

Masat:

Masa 1: Përfshirja e informacionit për mbrojtjen e ujit dhe zonat e mbrojtjes sanitare të ujit në kurrikulat e trajnimit dhe materialet e trajnimit për përdoruesit e PMB-ve, shitësit e PMB-ve, konsulentët.

Masa 2: Përfshirja e mbrojtjes së ujit nga pesticidet në materialet e ndërgjegjësimit dhe shkëmbimit të njohurive për përdoruesit e PMB-ve, shitësit e PMB-ve, konsulentët.

Masa 3: Përfshirja e analizave të pesticideve në monitorimin e jashtëm të ujit të pijshëm.

Masa 4: Rritja e kapaciteteve analitike në laboratorin(ët) përgjegjës për analizën e pesticideve në ujin e destinuar për konsum njerëzor.

Masa 5: Akreditimi i laboratorëve publikë për analizat e pesticideve në ujë.

5.5.4 Distanca e sigurisë nga ujërat sipërfaqësore

Situata aktuale:

Aplikimi i PMB-ve në bujqësi mund të çojë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore. Prandaj, ekziston nevoja për të krijuar zona sigurie për distancën e sigurisë nga mjediset ujorë, për t'i mbrojtur ata nga efektet anësore të përdorimit të PMB-ve. Zonat e sigurisë janë një mjet i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut për të mbrojtur cilësinë dhe sigurinë e ujit dhe mjedisit ujor, pasi brenda këtyre zonave, përdorimi i PMB-ve është i ndaluar.

Madhësia e distancës së sigurisë mund të ndryshojë në varësi të karakteristikave të tokës dhe klimës, vetive eko-toksikologjike të pesticideve, kulturave të mbjella dhe teknologjisë së aplikuar të bimëve, numrit të aplikimeve të PMB-ve dhe ndjeshmërisë së ekosistemit ujor. Gjerësia minimale e zonës së sigurisë mund të jetë 5 m dhe mund të shtrihet deri në 10-15 m, duke siguruar mbrojtjen e mjedisve ujorë nga ndotja me pesticide.

Objektivi:

Reduktimi ose eliminimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore duke krijuar zona sigurie të mbuluara në mënyrë të përhershme me bimësi.

Synimi:

Rritja me 70% (40% deri në vitin 2028 dhe 70% deri në vitin 2032) e sipërfaqes së gjelbër në krahasim me vitin e parë të përdorimit të PMB-ve, midis territoreve bujqësore dhe ujërave sipërfaqësore, si dhe miratimi i rregulloreve që lejojnë përdorimin e PMB-ve që janë të etiketuara si jo të dëmshme për organizmat ujorë në të gjitha territoret bujqësore që ndodhen në afërsi të ujërave sipërfaqësore.

Treguesit:

Madhësia e sipërfaqes së gjelbër, e krijuar në afërsi të sipërfaqeve ujore dhe përpilimi i listës së pesticideve jo të dëmshme për organizmat ujorë.

Masat:

Masa 1: Stimulimi i krijimit të zonave sigurie, të mbuluara me bimësi të përhershme, dhe me gjerësi të paktën 5 m, veçanërisht në sipërfaqet bujqësore që ndodhen në afërsi të drejtpërdrejtë të ujërave sipërfaqësore, për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe organizmave ujorë.

Masa 2: Krijimi i një sistemi monitorimi për respektimin e kërkesave për ndalimin dhe kufizimin e përdorimit të PMB-ve në zonat e mbrojtura.

5.5 Reduktimi i përdorimit të PMB-ve në zona të veçanta**Situata aktuale:**

Përdorimi i PMB-ve mund të jetë veçanërisht i rrezikshëm në zona të caktuara specifike ose në sipërfaqe jo bujqësore; prandaj, përdorimi i PMB-ve duhet të minimizohet ose ndalohet në zona të tilla. Për më tepër, do të merren masat e duhura të menaxhimit të rrezikut dhe përdorimi i

produkteve të mbrojtjes së bimëve me rrezik të ulët siç përcaktohet në Rregulloren (KE) Nr. 1107/2009, si dhe do të merren parasysh në radhë të parë masat e kontrollit biologjik.

Kjo veçanërisht i referohet fushave specifike të mëposhtme:

(i) zonat e gjelbra dhe parqet e përdorura nga publiku i gjerë, ose nga grupet vulnerabël siç përcaktohet në nenin 3 të Rregullores (KE) Nr 1107/2009, në afërsi të ndërtesave të banimit, shkollave, kopshteve, shtëpive të pushimit, spitaleve dhe kujdesit tjetër shëndetësor, objektet ku është e vështirë të parandalohet hyrja e njerëzve, veçanërisht fëmijëve, kafshëve dhe kafshëve shtëpiake në zonat e trajtuara, ose zona menjëherë pas trajtimit;

(ii) zonat e mbrojtura ose zonat shumë të ndjeshme, të tilla si zonat Natura 2000, të mbrojtura në përputhje me Direktivën e Këshillit 79/409/KEE të datës 2 prill 1979 për ruajtjen e shpendëve të egër dhe Direktivën e Këshillit 92/43/KEE e datës 21 maj 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore, si edhe të faunës dhe florës së egër;

(iii) zonat e trajtuara së fundmi të përdorura ose të aksesueshme nga punëtorët e bujqësisë

Në këto zona specifike, përdorimi i PMB-ve të kategorisë profesionale duhet të ndalohej edhe në rastet kur përdoruesi profesionist nuk është në gjendje të sigurojë aplikimin e sigurt të PMB-ve dhe ka metoda alternative për kontrollin e dëmtuesve në bimë. Ruajtja e bimëve në gjendje të mirë në hapësirat e gjelbra publike në kushte ekspozimi ndaj një sërë faktorësh pengues, është një sfidë shtesë për kompanitë që merren me mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike dhe shëndetin e bimëve. Për këtë arsye, është e nevojshme të sigurohet mbrojtje dhe përgatitja e kujdeseshme e bimëve në fidanishte, dhe pas rimbjelljes të aplikohen masa agroteknike si përgatitja e tokës, ujitja, plehërimi, heqja e gjetheve dhe pjesëve të infektuara të bimës nga plantacionet, si edhe të tjera masa mekanike, që krijojnë kushte më të mira për rritjen dhe zhvillimin e bimëve. Këto masa zvogëlojnë praninë e dëmtuesve dhe lejojnë konsumin më të vogël të pesticideve me rezultate të mira në ruajtjen e zonave të gjelbra. Në rastet e përdorimit të PMB-ve, prioritet duhet të kenë gjithmonë PMB-të me rrezikshmëri më të ulët.

Në Shqipëri, përdorimi i PMB-ve në këto zona specifike, rregullohet me VKM nr. 317, datë 15.5.2019 “Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe kritereve për kualifikimin e përdoruesve”. Bazuar në këtë VKM, ndalohej spërkatja ajrore e PMB-ve, ndalohej përdorimi i PMB-ve të rrezikshme në zonat e gjelbra publike, në zonat jobujqësore dhe në zonat e mbrojtura. Përdorimi i PMB-ve në zona të tilla, lejohet vetëm në raste specifike dhe të nevojshme kur alternativat e tjera të kontrollit të dëmtuesve janë joefektive dhe kjo duhet të bëhet nën kontrollin e pushtetit vendor dhe institucioneve të tjera përkatëse për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve. Për më tepër, rekomandohet përdorimi i PMB-ve me rrezik të ulët për mjedisin, florën dhe faunën dhe shëndetin e njeriut.

Objektivi:

Reduktimi i ekspozimit të njerëzve ndaj PMB-ve në ose afër zonave jobujqësore, si parqet publike, zonat e argëtimit, shkollat, kopshtet, shtëpitë e pushimit, spitalet dhe objektet e tjera të kujdesit shëndetësor.

Synimi:

Parandalimi dhe/ose zvogëlimi i rreziqeve të përdorimit të PMB-ve në zonat publike dhe argëtuese, duke siguruar kështu mbrojtjen e publikut të gjerë dhe grupeve specifike të cenueshme të popullsisë.

Eliminimi i ndotjes në zonat e mbrojtura dhe mbrojtja e stafit nëpërmjet reduktimit të ekspozimit të tyre ndaj PMB-ve.

Treguesit:

Numri i shkeljeve që përfshijnë përdorimin e PMB-ve të kategorisë profesionale në zonat e përdorura nga publiku i gjerë, zonat e mbrojtura dhe zona të tjera specifike; numri i shkeljeve që përfshijnë përdorimin e PMB-ve në zonat e mbrojtura për të cilat është vendosur ndalimi i përdorimit të PMB-ve.

Numri i incidenteve me persona (helmime, etj.) të shkaktuara në këto zona specifike, për shkak të përdorimit të PMB-ve.

Masat:

Masa 1: Ndalimi i përdorimit të PMB-ve të kategorisë profesionale në zonat e përdorura nga publiku i gjerë ose grupet vulnerabël; në raste të jashtëzakonshme, nëse zona të tilla duhet të trajtohen, mund të përdoren vetëm PMB të kategorisë joprofesionale, PMB me rrezik të ulët ose agjentë e kontrollit biologjikë.

Masa 2: Ndalimi i përdorimit të PMB-ve të kategorisë profesionale në zonat e mbrojtura; nëse zona të tilla duhet të trajtohen, duhet të përdoren PMB të kategorisë së përdorimit joprofesional, PMB me rrezik të ulët ose agjentë e kontrollit biologjikë.

Masa 3: Dhënia e përparësisë ndaj masave jokimike (p.sh. mekanike, fizike, biologjike dhe bioteknike) të mbrojtjes së bimëve në zonat specifike, me zbatimin e detyrueshëm të masave parandaluese që synojnë reduktimin e rasteve të dëmtuesve.

5.6 Trajtimi dhe ruajtja e PMB-ve dhe trajtimi i paketimit dhe mbetjeve të tyre nga përdoruesit profesionistë

Gjendja aktuale

Në ligjin bazë, nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, në nenet nr. 22, 23, 24 dhe 25, përcaktohen përkatësisht rregullat dhe kriteret e përgjithshme për transportin dhe ruajtjen e PMB-ve, përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve, paketimin e PMB-ve, asgjësimin e PMB-ve dhe te paketimeve te tyre.

Janë miratuar dhe aprovuar standardet e ruajtjes për produktet me përdorim profesional, duke pasqyruar rreziqet që lidhen me PMB-të që ruhen, si dhe vendndodhjen e objektit të magazinimit, afërsinë e tij me hapsira te caktuara peizazhi, hapësira publike, etj.

Janë miratuar dhe aprovuar standardet për produktet e përdorimit të zakonshëm, duke marrë parasysh çështje të tilla si llojet e produkteve në fjalë, aksesit i produkteve për fëmijët, afërsia me produktet e tjera që shiten me pakicë (ushqimi për kafshët, produktet ushqimore, etj.).

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), është përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, si dhe për kontrollin e përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, objekt i këtij ligji.

Në kuadër të këtij ligji, është miratuar VKM nr. 532, datë 11.9.2018 “Për miratimin e rregullave, për tregtimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve”. Përgjegjës për zbatimin e kësaj VKM-je, janë AKU dhe ISUV.

Të dhënat e marra nga struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve në Ministrinë e Bujqësisë, tregojnë se mund të shkaktohen probleme nga mungesa e kapaciteteve për asgjësimin e PMB-ve të bllokuara/ndaluara për shitje në ambientet e njëjstive të tregtisë me shumicë dhe pakicë, ndër vite. Kjo strukturë ka raportuar se për periudhën 2017-2020 ka pasur rreth 2.5 tonë pesticide të tilla të bllokuara/të ndaluara.

Është e nevojshme që VKM-ja e sipërpërmendur të ndryshohet dhe të shoqërohet me udhëzime të përbashkëta nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Aktualisht MBZHR-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, po krijojnë një grup pune për hartimin e udhëzimit për asgjësimin e PMB-ve dhe paketimit të tyre, sipas pikës 4, neni 25, të ligjit nr. 105/2016, datë 27.10.2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

Objektivi:

PMB-të ruhen dhe trajtohen në mënyrë të përshtatshme nga të gjithë individët që i mbajnë në ambientet e tyre, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i kontaminimit të operatorëve dhe kalimtarëve, si edhe potenciali për dëmtim të mjedisit.

Synimi:

Të gjitha PMB do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në të gjitha ambientet. Lokalet plotësojnë standardet e ruajtjes dhe shitjes të përcaktuara në legjisllacionin kombëtar.

Të gjitha ambientet e përfshira në shitjen ose furnizimin e PMB -ve (produkte profesionale dhe amatore) kanë staf të përshtatshëm të trajnuar, të njohur me kërkesat e kërkuara të ruajtjes dhe ekspozimit, të disponueshëm në çdo kohë.

Të gjitha mbetjet e PMB-ve dhe kontejnerët e zbrazët, asgjësohen siç duhet, sipas standardeve kombëtare dhe UE, dhe në një mënyrë miqësore me mjedisin.

Treguesit:

Numri/përqindja e magazinave, në nivel shitje/shpërndarësi, që janë konstatuar në përputhje me standardet specifike ligjore në momentin e inspektimit nga autoriteti kompetent.

Numri/përqindja e magazinave, në nivel përdoruesi profesionist, në përputhje me standardet specifike ligjore, në momentin e inspektimit nga autoriteti kompetent.

Numri/përqindja e PMB-ve, që nuk janë në përputhje me kërkesat e paketimit dhe etiketimit, në momentin e inspektimit, nga autoriteti kompetent.

Numri/përqindja e shitësve me shumicë dhe pakicë të PMB-ve profesionale, në përputhje me kërkesat e mbajtjes së të dhënave, do të regjistrohet në momentin e inspektimit nga autoriteti kompetent.

Regjistrimi i sasisë së mbetjeve të asgjesuara në mënyrë të përshtatshme.

Masat:

Masa 1: MBZHR-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duhet të përgatisin dhe miratojnë udhëzimet për asgjësimin e PMB-ve dhe paketimit të tyre, sipas pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr.105/2016, datë 27.10.2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar.

Masa 2: Çdo operator biznesi i përfshirë në shitjen e PMB-ve (produkteve profesionale dhe amatore), do të jetë i detyruar të ketë një person të trajnuar siç duhet për rreziqet e pesticideve, të disponueshëm në çdo kohë në pikën e shitjes ose furnizimit.

Masa 3: Të gjithë tregtarët me shumicë dhe pakicë të PMB-ve profesionale, do të jenë të detyruar të regjistrojnë detajet, siç përcaktohet nga legjislacioni kombëtar, për shitjen dhe furnizimin e këtyre produkteve. Këto të dhëna duhet të mbahen për një periudhë prej të paktën 5 vjetësh dhe të vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente me kërkesë të tyre.

5.7 Menaxhimi i integruar i dëmtuesve (MID)

Situata aktuale:

Menaxhimi i integruar i dëmtuesve, nënkupton shqyrtimin e kujdesshëm të të gjitha metodave të vlefshme të mbrojtjes së bimëve dhe integrimin e masave të duhura që dekurajojnë zhvillimin e popullatave të dëmtuesve dhe që mbajnë përdorimin e PMB-ve dhe formave të tjera të ndërhyrjes në nivele që janë të justifikuara ekonomikisht dhe ekologjikisht, si dhe për të reduktuar ose minimizuar rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Menaxhimi i integruar i dëmtuesve thekson rritjen e shëndetshme të bimëve me ndërhyrje sa më të vogla të mundshme në agroekosistemet, si edhe inkurajon mekanizmat natyrorë të kontrollit të dëmtuesve.

Masat, metodat dhe afatet e çrrënjësjes, përcaktohen vetëm për sëmundjet e bimëve, dëmtuesve ose barërat e dëmshme me rëndësi ekonomike, bazuar në prognozën dhe infeksionin në plantacione ose kultura.

Kjo qasje sot quhet e qëndrueshme, dhe sistemi i prodhimit quhet prodhim i qëndrueshëm. Parandalimi dhe/ose “shtypja” e organizmave të dëmshëm, duhet të arrihet ose të mbështetet midis opsioneve të tjera (të qëndrueshme), veçanërisht përmes: qarkullimit bujqësor, përdorimit të teknikave adekuate të kultivimit si p.sh. teknika e shtratit të farës së ndenjtur (për kontrollin e

bimëve të dëmshme), datat dhe dendësia e mbjelljes, punimi minimal i tokës, mbjellja direkte, përdorimi, kur është e përshtatshme, i kultivarëve rezistent/tolerantë dhe farërave dhe materialit mbjellës standard të certifikuar, përdorimi i praktikave të balancuara të plehërimit, gëlqeres dhe ujitjes/kullimit, duke parandaluar përhapjen e organizmave të dëmshëm me masa higjienike (p.sh. me pastrim të rregullt të makinerive dhe pajisjeve).

Në plan të parë vjen zbatimi i MID në sektorët kyç të prodhimit bujqësor dhe veçanërisht në fermat me sipërfaqe më të mëdha, ku mbrojtja e bimëve tenton të kryhet duke përdorur metoda konvencionale.

Tendenca për të hyrë sa më shpejt në treg, veçanërisht në perimet e serave, ndryshimet klimatike, nivelet e ulëta të trajnimit të fermerëve, fermat e reja me menaxherë joprofesionistë, në shumë raste mungesa e përgatitjes së tyre për ndryshime të mundshme në diapazonin e shpërndarjes së dëmtuesve (patogjenë kërpudha, baktere, viruse, insekte, nematoda, fitoplazma, dhe bimët e dëmshme) e bëjnë më të vështirë zbatimin e sistemeve të qëndrueshme, si MID.

Disa ferma shqiptare, e kanë zbatuar MID për kultura të ndryshme. Zakonisht kjo ka qenë në kuadër të projekteve të ndryshme, kryesisht me financime të huaja.

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka punuar me disa ferma në kuadër të studimeve të doktoraturës, por edhe studimeve të specialistëve të ndryshëm për zbatimin e MID në ferma. Realiteti është se kjo praktikë nuk përdoret në shumicën e fermave, ndaj ka ende shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Objektivi:

MID ndiqet nga të gjithë konsulentët në mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe përdoruesit profesionistë të PMB-ve, nëpërmjet përdorimit të matur të PMB-ve, përdorimit të teknikave jo-PMB, zgjedhjes së varieteteve, teknikave të kultivimit, qarkullimit bujqësor, etj.

Synimi:

Deri në vitin 2032, të gjithë fermerët profesionistë në Shqipëri ndjekin parimet e MID në prodhimin e tyre bimor.

Hartimi i udhëzimeve specifike për kulturat për mbrojtjen e integruar të bimëve për të gjitha kulturat ose sektorët përkatës, duke iu referuar sipërfaqes totale bujqësore dhe nivelit të intensitetit të përdorimit të PMB-ve në fermat e përfshira në aktivitetet e mbrojtjes së bimëve; kjo përfshin një përshkrim dhe vlerësim sistematik të metodave të disponueshme të mbrojtjes së integruar të bimëve.

Përpunimi/formulimi i strategjive për të rritur rezistencën e bimëve në mënyrë që të sigurohet një menaxhim i duhur për kulturat dhe sektorët e rëndësishëm.

Rritja e numrit të llojeve të pajisjeve për mbrojtjen e bimëve që lejojnë reduktimin e sasisë së produkteve për mbrojtjen e bimëve të përdorura.

Reduktimi i përdorimit të lëndëve vepruese të klasifikuara si “shqetësuese të veçanta”, me qëllim që të zvogëlohet rreziku.

Treguesit:

Numri i protokolleve MID të hartuara/përditësuara për kulturat kryesore.

Numri i kultivarëve rezistent, të futur në prodhim.

Numri i fermerëve që mbjellin kultivarë rezistent në fermat e tyre.

Numri i fermerëve që mbjellin farëra dhe fidane të certifikuara.

Numri i fermerëve që aplikojnë metoda biologjike në menaxhimin edëmtuesve.

Regjistri i fermerëve që zbatojnë parimet e menaxhimit të integruar të dëmtuesve në prodhimin bujqësor.

Numri/përqindja e fermerëve të gjetur në kontrollet zyrtare që ndjekin parimet e MID në prodhimin e tyre bimor.

Masat:

Masa 1: Zhvillimi ose përditësimi i protokolleve të menaxhimit të integruar të dëmtuesve për kulturat bujqësore kryesore.

Masa 2: Hartimi i një programi trajnimi dinamik dhe profesional me fokus në përdorimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të PMB-ve në kuadër të qasjes MID.

Masa 3: Identifikimi i lëndëve vepruese, me rrezikshmëri të lartë në përdorim (helmue, shumë helmues, bioakumuluese) dhe rekomandime për zëvendësimin e tyre me lëndë vepruese të tjera, më pak të rrezikshme për shëndetin e njeriut ose mjedisin.

Masa 4: Vendorsja ose përditësimi i pragut ekonomik të trajtimit për dëmtuesit më të rëndësishëm të kulturave kryesore, duke përdorur metodologji të përditësuara.

Masa 5: Ministria të promovojë strategjitë e rezistencës duke dhënë informacion dhe duke u dhënë përparësi kultivarëve rezistentë ndaj dëmtuesve, si dhe farave dhe fidanëve të certifikuar.

Masa 6: Ministria promovon dhe mbështet financiarisht fermerët që aplikojnë metoda të qëndrueshme biologjike, fizike dhe metoda të tjera jokimike, nëse ato ofrojnë kontroll të mirë të dëmtuesve, si dhe praktika të mira bujqësore (qarkullimi bujqësor, plehërimi i balancuar, etj).

Masa 7: Promovimi dhe mbështetja e bujqësisë organike

Masa 8: Hartimi dhe mirëmbajtja e një regjistri, për fermerët e angazhuar në prodhimin bujqësor, sipas parimeve të menaxhimit të integruar të dëmtuesve.

Masa 9: MBZHR dhe AKVMB të kontrollojnë përdoruesit profesionistë, për të mbajtur përdorimin e PMB-ve dhe formave të tjera të ndërhyrjes në nivelet më të ulëta të nevojshme, p.sh. përdorimi i dozave të reduktuara të PMB-ve, frekuenca e reduktuar e aplikimit ose aplikimet e pjesshme, duke marrë parasysh nivelin e pranueshëm të rrezikut në vegjetacion dhe shmangien e rrezikut të shtuar të zhvillimit të rezistencës në popullatat e organizmave të dëmshëm. Rezultatet e këtyre kontrolleve, duhet të tregojnë nëse fermeri përdor MID në prodhimin e tij bimor.

Masa 10: Rishikimi i vazhdueshëm i planit të monitorimit për mbetjet e pesticideve të produkteve me origjinë bimore.

Masa 11: Publikimi i raporteve për mbetjet e pesticideve, duhet të bëhet në mënyrë periodike (të paktën një herë në dy vjet).